



REVISTË SHML "MEDRESEJA ALAUDDIN" PRISHTINË



Nr. 51 / Qershor 2025

DRITA e نور القرآن KURANIT



Fjala e KRYEREDAKTORES

Të nderuar lexues,

Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit.

Falënderimi dhe lavdërimi i takojnë vetëm Allahut, Zotit të botëve. Paqja dhe mëshira e Tij qofshin mbi Muhamedin (a.s.), familjen e tij, shokët e tij dhe mbi të gjithë ndjekësit e rrugës së tij deri në Ditën e Gjykimit.

Me kënaqësi dhe përgjegjësi, redaksia e revistës “Drita e Kuranit”, ju paraqet numrin më të ri të revistës shkollore, e cila pasqyron jetën tonë arsimore, edukative dhe shpirtërore.

Çdo faqe që do të shfletoni është fryt i punës së përkushtuar të nxënësve dhe mësimdhënësve tanë – me shkrime, ide, përvoja dhe me mbështetjen e pakursyer të drejtorit të shkollës. Brenda saj do të gjeni tema të shumta: nga ngjarjet e rëndësishme shkollore dhe reflektimet fetare, deri te krijimtaria letrare e artistike, si dhe mendime e analiza që burojnë nga zemra dhe mendja e nxënësve tanë.

Qëllimi i kësaj reviste është i qartë: të informojë, të motivojë dhe të ruajë frymën e bashkëpunimit dhe përparimit që na karakterizon si institucion arsimor e fetar.

Falënderojmë të gjithë ata që kontribuan në realizimin e këtij botimi. Pa përkushtimin dhe bashkëpunimin e tyre të çmuar, kjo punë nuk do të mund të bëhej realitet.

Ju urojmë lexim të këndshëm dhe të dobishëm!

Bashkësia Islame e Kosovës

Boton: SHML “Medreseja Alauddin”- Prishtinë

Për botuesin: Mr. Fadil Hasani, drejtor

Kryeredaktore: Lumnie Sadiku 12/4

Redaktor: Ron Bajoku 12/2

Anëtarë: Melos Surkishi 12/1, Uveys Pajaziti 12/2, Anila Berisha 12/3, Alkam Ademi 11/2,

Emira Mehani 11/4, Dijar Mehani 10/1, Mirjeta Januzi 10/3, Esma Maliqi 10/5.

Lektor dhe redaktor gjuhësor: Ruvejda Bejtullahu 12/4

Redaktura teknike: Bashkim Mehani

Dizajni: Emir Mehani

E-mail: medreseja@gmail.com/redaksia24@gmail.com

www.medreseja.com





PËRMBAJTJA



- | | | | |
|----|---|----|--|
| 3 | FJALAL E KRYEREDAKTORES | 37 | NATA E KADRIT, MES DRITËS SË KURANIT DHE
EDUKIMIT SHPIRTËROR |
| 4 | PËRMBAJTJA | 38 | BOTIME TË REJA NGA PROFESORËT E
MEDRESESË ALAUDDIN |
| 5 | KOHA QË NUK KTHEHET | 39 | SHML "MEDRESEJA ALAUDDIN" PARALELJA NË
PRIZREN, ORGANIZON AKTIVITET EKOLOGJIK |
| 5 | LETRA QË S'MBËRRITI KURRË | 40 | DELEGACIONI NGA STAMBOLLI VIZITOI
MEDRESENË ALAUDDIN |
| 6 | STRENGTH THROUGH FAITH | 41 | GARAT E DITURISË 2025 |
| 7 | KUFIJ QË NDA JNË, SHPRESË QË BAS HKON | 43 | NDËRGJEGJËSIM PËR RREZIQET E ARMBAJTJES
NË SHKOLLA |
| 8 | LAMTUMIRA QË DHEMB SHUMË | 44 | PANAIRI SHKENCOR |
| 8 | NË HESHTJE RRITEMI | 47 | DUAJA E HATMES – GJENERATA E 24-TË E
VAJZAVE TË MEDRESESË ALAUDDIN |
| 9 | GJENDJA IME ME ALLAHUN | 49 | DUAJA E HATMES – GJENERATA E 58-TË E
DJEMVE TË MEDRESESË ALAUDDIN |
| 10 | صلاة الفرض | 51 | MEDRESEJA ALAUDDIN NË TRAJNIM PËR
LIDERSHIP |
| 11 | KEEP ME STEADFAST, MY LORD | 51 | DELEGACIONI I NGA LONDRA VIZITON
MEDRESENË ALAUDDIN |
| 12 | ENIGMA E FORMIMIT | 52 | VIZITË ZYRTARE NË MEDRESENË "ISA BEU" NË
SHKUP |
| 13 | SPORT | 53 | GARAT BALLKANIKE TË KURANIT 2025 |
| 19 | ART | 53 | VIZITA STUDIMORE E KLASËS 11/3 |
| 22 | PIKTORJA E SHKOLLËS | 54 | VIZITË STUDIMORE NË FERRONIKEL |
| 23 | NXËNËSJA E DALLUAR, RUVEJDA BEJTULLAHU | 54 | SHËTITJE KULTURORE NË KOSOVË |
| 24 | NXËNËSI I DALLUAR, RON BAJOKU | 55 | PROGRAM LAMTUMIRËS PËR GJENERATËN E
24-TË |
| 25 | NXËNËSIT DHE NXËNËSET E DALLUARA TË
MEDRESESË ALAUDDIN VIZITONË TURQINË | 56 | DY MBRËMJE PLOT EMOCIONE, KUJTIME DHE
MIRËNJOHJE – LAMTUMIRA E GJENERATËS SË
24-TË DHE 58-TË |
| 26 | TRAJNIM KUNDËR BULLIZMIT | 57 | POEZI |
| 26 | NXËNËSIT DHE STAFI DHUROJNË GJAK | 59 | KËSHILLA TË ARTA NGA PROFESORËT |
| 27 | VIZITA E DELEGACIONIT TË MEDRESESË
ALAUDDIN NË TURQI | 60 | FJALËT E FUNDIT TË MATURANTËVE |
| 28 | "ESEJA MË E MIRË" – GARA NË MEDRESENË
ALAUDDIN, NË PARALELEN E GJILANIT | 64 | FOTOALBUME TË NXËNËSVE SIPAS KLASËVE |
| 29 | PARLAMENTI I NXËNËSVE MBAN SEANCËN E
RREGULLT | | |
| 30 | DITA NDËRKOMBËTARE E VAJZAVE NË SHKENCË | | |
| 31 | NXËNËSET E MEDRESESË ALAUDDIN NDËR 10 MË
TË MIRAT NË GARËN E ESESË TË QENDRËS "DON
BOSKO" | | |
| 32 | PROGRAM FESTIV NË SHML "MEDRESEJA
ALAUDDIN" PËR NDER TË 17 SHKURTIT | | |
| 33 | NGA RRËNOJAT E LUFTËS U NGRIT NJË SHTET | | |
| 34 | MUAJI SHKURT – MUAJI I HIXHABIT | | |
| 34 | VIZITË NGA PËRFAQËSUESIT E UP-SË | | |
| 35 | NË PRITJE TË RAMAZANIT TË BEKUAR | | |
| 36 | FRYMA E RAMAZANIT NË SHKOLLËN TONË | | |
| 36 | "ISRAJA DHE MIRAXHI" - LIGJËRATË NË
MEDRESENË ALAUDDIN | | |

KOHA QË NUK KTHEHET

Koha ecën pa ndalur. Asnjë orë nuk pret, asnjë minutë nuk kthehet pas. Çdo ditë që kalon bëhet kujtim. Disa i ruajmë me mall, disa i harrojmë shpejt, por të gjitha kanë lënë gjurmë. Ne shpesh themi “ka kohë”, por nuk e kuptojmë sa e çmuar është ajo. Harxhojmë orë të tëra duke pritur, duke u ankuar, duke u marrë me gjëra pa rëndësi dhe kur kuptojmë vlerën e vërtetë të kohës, ndoshta është pak vonë. Koha nuk është armik, është mësues. Na mëson të falim, të duam, të presim, të vlerësojmë. Na mëson se çdo moment është i rëndësishëm jo sepse është i madh, por sepse nuk përsëritet kurrë më njësoj.

Mos e prit ditën perfekte për të jetuar. Mos prit që gjithçka të jetë në vendin e duhur. Koha më e mirë është tani. Bëj një veprim të mirë, thuaj një fjalë të bukur, mëso diçka të re, buzëqesh. Sepse koha nuk pyet – ajo ecën. Dhe jeta jonë ecën bashkë me të.

Dinore Shala 12/4

LETRA QË S'MBËRRITI KURRË

Diku, në një sirtar të pluhurosur, ndodhet një letër që s'mbërriti kurrë në destinacionin e saj. Letra ka një aromë letre të vjetër dhe fjalë të ngrohta që askush nuk i lexoi. Ajo është palosur me kujdes, si një sekret i vogël që koha e harroi.

Ndoshta është një letër dashurie, shkruar me duar që dridheshin paksa. Ndoshta është një falje, e mbetur pezull mes krenarisë dhe frikës. Apo ndoshta është thjesht një mendim i shprehur me vonesë – një “Më mungon” ose një “Të faleminderit” që nuk e gjeti kurrë rrugën drejt atij që duhej ta dëgjonte. Sa letra të tilla kemi shkruar në mendjet tona? Sa fjalë kemi mbajtur për vete, duke besuar se do të kemi gjithmonë një “nesër” për t'i thënë? Dhe sa shpesh koha na ka treguar se nesër mund të jetë tepër vonë?

Le të mos i lëmë fjalët të pluhurosen si letra të padorëzuara. Le t'i themi sot ato që kemi në zemër – pa frikë e pa vonesë. Sepse fjalët e pathëna janë si letrat që s'mbërritën kurrë, dhe ndoshta dikush, diku, është duke pritur të dëgjojë pikërisht ato.

Ernesa Spahiu 12/4



STRENGTH THROUGH FAITH

She walks her own path, guided by her faith, knowing her worth without needing validation from others. Rooted in the teachings of Islam, she finds strength in the belief that her value is defined by Allah, not by society. She doesn't depend on others for her happiness or success, as she trusts in her own abilities. Challenges come, but with faith and resilience, she faces them head-on, knowing that Allah's guidance will carry her through. Her

confidence is steady, and she builds her future, one choice at a time, knowing she is enough.

She is not afraid to be different. She knows that walking with Allah may set her apart, but it also sets her free. Her path is not always easy, but it is always meaningful.

True strength comes from faith in Allah and confidence in yourself.

Medina Musliu 12/4



KUFIJ QË NDA JNË, SHPRESË QË BAS HKON

Ruga e gjatë shtrihej përpara dhe Rsa më shumë e ndiqja, aq më tepër zgjatej. Jo vetëm kaq – edhe rrezet e diellit, me një lloj cinizmi, sikur përpiqeshin të më tregonin se isha diku ku as vetë nuk e dija ku ndodhesha. Epo, formalisht e dija se për ku isha nisur. Destination në telefonin tim tregonte: Tiranë. Një vend i bukur, ku bukuria dhe madhështia janë thjesht disa shprehje të thata që përpiqen ta përshkruajnë këtë qytet. Kështu kisha ndërtuar idenë në mendjen time – një përfytyrim që e kisha ushqyer gjatë. Por siç thuhet, çdo gjë zbulohet me kohën.

U afruam në kufirin fizik mes Kosovës dhe Shqipërisë – kufi që na ndan fizikisht, por jo kombësisht. Çfarë them edhe unë! U desh të ndaleshim gjatë në kufi, të identifikoheshim përmes pasaportave, e në fund të na lejohej kalimi në “shtetin tjetër”. Desha të mos mendoja më kështu, ndaj hapa telefonin me shpresë se do lexoja ndonjë poemë për Shqipërinë dhe bukuritë e saj... por, s’kishte internet. Sërish mendoja: na ndan kufiri, dhe ja – nuk bëhet as interneti! Si e mendojmë vallë ta realizojmë atë

konceptin e famshëm, që përdoret vetëm për slogane politike: “bashkimi kombëtar”?

Kur më erdhi kjo në mendje, nisa të mendoj për premtimet boshe, për fjalët e mëdha që i thurën kësaj ideje. E kuptova se sa pak punohet realisht për të, dhe sa shumë thjesht lartësohet për qëllime retorike. Kjo çështje, në thelb, është një paradoks i qartë.

Më dhimbset Naimi, që tërë jetën e tij u përpoq të shpërndante shpresë dhe pozitivitet për kombin shqiptar. Jo vetëm kaq – nisa të kuptoj më mirë pse Fishta shkruante aq ashpër për gjendjen e shqiptarëve. Ai s’e bënte nga mllefi, por nga dhimbja dhe dashuria për popullin e tij.

Në fund të fundit, çfarë mund të bëjmë? Duhet të përshtatemi me situatën tonë. Ajo që mund të bëjmë tani është ta lusim Zotin e Madhërisëm që të na përmirësojë gjendjen, dhe të na forcojë. Sepse, vërtet – siç thotë populli – “punët mirë nuk janë”.

Por megjithatë, nuk na humbin shpresat. Sepse ndryshimi nuk vjen duke e pritur, por duke punuar për të dhe duke besuar vërtet në të.

Andaj, ende po shpresojmë...

Shpëtim Smajli 12/1

LAMTUMIRA QË DHEMB SHUMË

Në fillim ishim të huaja për njëra-tjetrën, vajza nga qytete të ndryshme, me ëndrra të ndryshme, të

mbledhura nën të njëjtën çati. Por pak nga pak, ajo dhomë e vogël u bë shtëpia jonë. U mësua me zërat, me zakonet, me netët e gjata duke biseduar deri në agim, me ndihmën e ndërsjellë kur jeta e largësisë bëhej e rëndë.

Kush do ta mendonte se mes mureve të ftohta të konviktit do të gjenim një ngrohtësi që askund tjetër nuk do ta gjenim? Sa herë ndamë kafshatën e fundit? Sa herë fshihnim lotët për familjen, vetëm që të mos lëndonim njëra-tjetrën? Sa herë qeshëm pa arsye, vetëm sepse të qenit bashkë na mjaftonte?

Por koha nuk pyet... Erdhi dita që s'e donim. Dhoma e dikurshme, e mbushur me jetë, tani është bosh. Valixhet janë mbushur, por zemrat tona janë të zbrazëta. Ishim një familje e bërë nga rastësia, por e lidhur nga dashuria. Ishim shoqe, motra, ndihmë për njëra-tjetrën kur jeta e largësisë bëhej e mundimtë.

E shikojmë njëra-tjetrën dhe kuptojmë diçka të tmerrshme, por të vërtetë – ky nuk është një largim i përkohshëm, kjo është një ndarje e pashmangshme.

Mundohemi të mos qajmë, por heshtja është e rëndë. Një përqaftim i fundit dhe pastaj... secila në rrugën e saj. Konvikti që dikur ishte shtëpia jonë tani është thjesht një ndërtesë, e ftohtë dhe e heshtur, si një kujtim që po na rrëshqet nga duart.

E di që do të shkruajmë, do të flasim, do të premtojmë takime... Por e vërteta është e hidhur – kurrë më nuk do të jemi njësoj. Kurrë më nuk do të ndajmë çdo ditë, çdo mëngjes, çdo natë.

Dhe kjo... kjo është lamtumira më e dhimbshme nga të gjitha.

Fatjona Gashi 12/3

NË HESHTJE RRITEMI

Ka rritje që s'ka zë. S'ka duartrokite. S'ka dritë skene. Ka vetëm hapa të vegjël që nuk i sheh askush – veç zemra jonë që i ndien. E në këtë heshtje, që shpesh duket e zakonshme, ndryshojmë më shumë se në çdo brohoritje. Pjekuria nuk bëhet me zhurmë, ajo rritet ngadalë, në kohën kur heshtim për të dëgjuar vetveten, kur zgjedhim të falim kur askush nuk po sheh, kur zemra zgjeron kufijtë e saj dhe kupton pa gjykuar. Aty, në atë qetësi, nis rrugëtimi ynë më i thellë.

Është në ato çaste kur heshtja bëhet mikja jonë më besnike, që na mban në prehërin e saj dhe na mëson se forca nuk është gjithmonë në zë të lartë. Forca është shpesh në butësinë e një shikimi, në ngrohtësinë e një buzëqeshjeje që as nuk shprehet me fjalë, në durimin e një zemre që pranon dhe rritet pa zhurmë.

Në heshtje, aty ku nuk shkon vëmendja e botës, lulëzon shpresa e brendshme – ajo shpresë e pathyeshme, e heshtur, që ngrihet si dritë e qetë në errësirën e brendshme. Dhe kjo shpresë, më e fortë se çdo zhurmë, na thotë: “Jeta nuk matet me duartrokite, por me atë qëndresë të heshtur që na bën më të mëdhenj.”

Sepse ajo që vërtet mbetet, nuk është jehona e çastit, por përqendrimi i heshtur i shpirtit që zgjeron horizontet tona. Në heshtje, mësojmë të jemi të sinqertë me veten, të falim me zemër, të ecim me besim, të dashurojmë pa kushte.

Në fund, kur gjithçka tjetër shuhet, heshtja e brendshme mbetet një dritare e ndritshme – një fener që ndriçon rrugën tonë të vërtetë. Dhe kur më në fund e dëgjojmë atë zë të brendshëm, kuptojmë se kemi ndryshuar — dhe ky ndryshim është dhurata më e bukur që mund t'i japim vetes.

Lumnije Sadiku 12/4

GJENDJA IME ME **ALLAHUN**

Sa herë që shkoj
Stë shtrihem
për të fjetur, më
kujtohet vdekja dhe
dalja para Allahut, por
në gjendjen që jam, nuk
jam e gatshme për ta takuar. Jo se
nuk e dua takimin me Të, por gjynahet
e shumta dhe adhurimet e pakta më
frikësojnë të dal në këtë gjendje para Tij.
Shpresa më mban se ndoshta e nesërmja
do të jetë ditë më e mirë se e sotmja, e
mbushur me pendim dhe keqardhje për
të kaluarën time. Zemra më qan kur në
sexhde qëndroj, them: “Çdo detaj të jetës

time e di, Zoti im. Çdo gjë jo
të mirë që kam përjetuar dhe
jam lënduar prej saj, e ke parë,
se Ty nuk të fshihet asgjë.”

U detajova në zemrën time, pashë
se është ngarkuar shumë me gjynahe,
saqë gjuha mbetet e shtangur për t'i
përshkruar ato. U trishtova kur pashë
se kjo gjendje e zemrës po e shkatërron
raportin me Ty, o Zoti im.

Andaj, sot unë u betova dhe fillova që
të shikoj gjendjen time me Allahun. Të
bëhem rob i mirë duke u kthyer te Ti
me një pendim të singërtë. Allahu na fal
neve për çdo gabim!

Diellza Berisha 12/4

صَلَاةُ الْفَرَضِ

أَحْيَانًا تَشْعُرُ أَنَّ إِيْمَانَكَ بَدَأَ يَضْعُفُ، وَأَنَّكَ لَمْ تَعُدْ تُصَلِّي كَمَا كُنْتَ مِنْ قَبْلُ، وَلَا تُؤَدِّي الصَّلَوَاتِ الْخَمْسَ كَمَا يَنْبَغِي، وَرَبَّمَا لَا تَتَوَجَّهُ إِلَى اللَّهِ فَوْزَ وَقُوعِ الشَّدَّةِ. وَلَكِنَّ مَا يَجِبُ أَنْ تَتَذَكَّرَهُ دَائِمًا هُوَ أَنَّ الْإِيْمَانَ لَيْسَ طَرِيقًا مُسْتَقِيمًا مُمَهَّدًا. الطَّرِيقُ إِلَى اللَّهِ مَلِيءٌ بِالْعَقَبَاتِ وَالْإِبْتِلَاءَاتِ الَّتِي تَأْتِي مِنَ الدُّنْيَا. جَمَالَ هَذَا الدِّينِ يَكْمُنُ فِي أَنَّ النُّمُوَّ فِيهِ مُسْتَمِرٌّ. لَوْ كُنَّا دَائِمًا عَلَى حَالَةٍ وَاحِدَةٍ مِنَ الثَّبَاتِ، لَمَا تَعَلَّمْنَا شَيْئًا مِنَ الْمَحْنِ. جِئْنَا تَتَذَكَّرُ أَهْنًا كُنْتَ أَوْ الْمَرْحَلَةَ الَّتِي تَطْمَحُ لِلْوُصُولِ إِلَيْهَا، فَلْيَكُنْ ذَلِكَ دَافِعًا لَكَ لِلْمَضِيِّ قَدَمًا. لَنْ نَبْلُغَ الْكَمَالَ أَبَدًا، وَلَكِنَّا نَسْتَطِيعُ أَنْ نَجْتَهِدَ دَائِمًا.


اللَّهُ يُجِبُّ الْمُجْتَهِدِينَ، وَيَعْلَمُ نَوَايَاكَ، وَيَعْلَمُ كَمْ نَحَاوَلْ، فَلَا تَطُنَّ يَوْمًا أَنَّكَ لَا تَفْعَلُ مَا يَكْفِي.

الْقَضِيَّةُ لَيْسَتْ فِي السَّقُوطِ، بَلْ فِي الْقُدْرَةِ عَلَى التُّهُؤِصِ مَرَّةً أُخْرَى. لَا تَجْلِدْ ذَاتَكَ، وَلَا تَقْسُ عَلَيْهَا.

إِذَا كُنْتَ تَجِدُ صُعُوبَةً فِي الصَّلَاةِ، فَابْدَأْ بِالْأَيْسَرِ مِنْهَا، وَشَيْذُ عَادَتِكَ تَدْرِيحِيًّا، يَوْمًا بَعْدَ يَوْمٍ. وَإِنْ كُنْتَ تَجِدُ صُعُوبَةً فِي الذِّكْرِ، فَادْكُرِ اللَّهَ فِي كُلِّ وَقْتٍ. وَإِنْ وَاجَهْتَ خَلًّا فِي تَنْظِيمِ يَوْمِكَ، فَاجْعَلِ صَلَاتَكَ هِيَ مَحْوَرَ يَوْمِكَ، وَسَتَنْزِلُ الْبَرَكَةُ فِي وَقْتِكَ.

وَإِنْ كُنْتَ تَفْتَقِرُ إِلَى السَّلَامِ الدَّاخِلِيِّ، فَاسْتَمِرَّ فِي التَّوَجُّهِ إِلَى «السَّلَامِ» - مَصْدَرِ السَّلَامِ. إِذْغِهِ أَنْ يُثَبِّتَكَ، وَأَنْ يَقُوْدَكَ إِلَى نُورِهِ. كُلُّنَا نَمُرُّ بِصَرَاعَاتٍ دَاخِلِيَّةٍ، وَكُلُّنَا فِي رِحْلَةٍ إِيْمَانِيَّةٍ خَاصَّةٍ، فَانْبُتْ، وَاجْتَهِدْ، وَاللَّهُ مَعَكَ.

Erda Musliu 12/4



KEEP ME STEADFAST, MY LORD

My heart is deeply wounded by the temptations of all four sides. Yet, the only treatment to heal, would be by You. Ya Rabb, as my heart cries and my mind is trying to articulate some words of expression, as my tongue is trying to utter those words, give me the strength I need and feed my soul with Your priceless love. I take an oath by Your Glory my Lord that, if I came to realize something for certain, it would be that I am completely

lost without You. I realized this after feeling the illuminating light of the most precious gift, Your guidance. Just then I realized what darkness had encompassed my vision before. I don't want to go further from You and the fear of the last breath betraying me is what breaks me. So O Merciful keep me steadfast in this path for Your Mercy's sake...

Keep me steadfast in the truth my Lord.

Sumeja Tahiri 12/3



ENIGMA E FORMIMIT


Njerëzimit iu deshën mijëra e mijëra vite për të zbuluar enigmën e krijimit dhe formimit të njeriut. Që prej kohës së filozofëve të lashtë grekë e deri më sot, ende nuk është larguar mjegulla që mbulon këtë enigmë.

Ndërsa muslimanëve, u mjaftoi vetëm të hapnin Librin e Zotit Fuqiplotë, në faqen 342, në kaptinën e emërtuar El Mu'minun (Besimtarët), dhe të lexonin ajetet 14-12 për të kuptuar këtë enigmë. Këto ajete mbresëlënëse janë si në vijim :

لَقَدْ خَلَقْنَا الْإِنْسَانَ مِنْ سُلَالَةٍ مِّن طِينٍ ﴿١٢﴾ ثُمَّ جَعَلْنَاهُ نُطْفَةً فِي قَرَارٍ مَّكِينٍ ﴿١٣﴾ ثُمَّ خَلَقْنَا النُّطْفَةَ عَلَقَةً فَخَلَقْنَا الْعَلَقَةَ مُضْغَةً فَخَلَقْنَا الْمُضْغَةَ عِظَامًا فَكَسَوْنَا الْعِظَامَ لَحْمًا ثُمَّ أَنشَأْنَاهُ خَلْقًا آخَرَ
فَتَبَارَكَ
اللَّهُ أَحْسَنُ الْخَالِقِينَ ﴿١٤﴾

“Me të vërtetë, Ne e kemi krijuar njeriun prej palcës së baltës (12), e pastaj e bëmë atë pikë fare dhe e vumë në një vend të sigurt (mitër) (13). E mandej, pikën e farës e bëmë droçkë gjaku, e pastaj e bëmë copëz mishi pa formë; mandej, me atë mish bëmë eshtrat, pastaj i veshëm eshtrat me mish dhe më pas e bëmë atë (njeriun) krijesë tjetër (duke i futur shpirtin). Qoftë lartësuar Allahu, Krijuesi më i përsosur!” (14)

[Sureja El-Mu'minun: 14-12]



Shpëtim Smajli 12/1

SPORT

TURNIRI I FUTBOLLIT PËR NDER TË 17 SHKURTIT



Në prag të Ditës së Pavarësisë së Kosovës, Medreseja Alauddin u mbush me emocione, ritëm dhe entuziazëm sportiv. Më 10 shkurt 2025, oborri i shkollës u shndërrua në arenë garuese, ku gjashtë ekipe nga Prishtina, Gjilani dhe Prizreni dhanë më të mirën në një turnir futbollit të organizuar me rastin e 17 Shkurtit.

Ky aktivitet mblodhi së bashku nxënës nga shkolla amë dhe paralelet e saj në Gjilan e Prizren. Gara

u zhvillua me ritëm të lartë, ndërsa çdo ndeshje solli emocione të forta dhe momente të paharrueshme, jo vetëm për lojtarët, por edhe për publikun që mbështeste me zell ekipet e veta.

Ajo që e bëri këtë turnir më shumë se një garë ishte fryma e bashkëpunimit dhe miqësisë që u ndërtua ndërmjet nxënësve.



PRISHTINA, KLASA E 11-të



PRISHTINA, KLASA E 12-të



GJILANI, KLASA 12/8



TURNIRI I VOLEJBOLLIT PËR NDER TË 17 SHKURTIT



Më 10 shkurt 2025, në sallën e sportit të Medresesë Alauddin në Prishtinë, u zhvillua Turniri i Volejbollit për vajza, organizuar me rastin e Ditës së Pavarësisë së Kosovës. Në këtë aktivitet morën pjesë ekipet e vajzave nga shkolla amë në Prishtinë dhe nga paralelet e ndara në Gjilan dhe Prizren. Ndashjet u zhvilluan në një atmosferë të mbushur me energji, entuziazëm dhe përkrahje nga publiku, ndërsa vajzat në fushë treguan përkushtim dhe lojë të shkëlqyer. Ky turnir u realizua me mbështetjen e stafit dhe angazhimin maksimal të nxënësve

pjesëmarrëse.

Rezultatet përfundimtare:

Vendi i parë – **Shkolla Amë, Prishtinë**

Vendi i dytë – **Paralelja e Gjilanit**

Vendi i tretë – **Paralelja e Prizrenit**

Ky aktivitet dëshmoi edhe një herë se sporti në Medrese nuk është vetëm garë, por edhe një mënyrë për të forcuar lidhjet mes nxënësve dhe për të festuar së bashku momentet më të rëndësishme për vendin tonë.



MEDRESEJA ZË VENDIN E DYTË NË KAMPIONATIN E SHAHUT


Më 3 shkurt 2024, në Shkollën e Gjelbër të Prishtinës, u mbajt kampionati ekipor i shahut për shkollat e mesme të larta të kryeqytetit. Ekipi i SHML “Medreseja Alauddin” zuri vendin e dytë, pas Gjimnazit “Sami Frashëri”. Kampionati u organizua nga Sporti Shkollor i Komunës së Prishtinës, në bashkëpunim me Federatën e Shahut të Kosovës dhe DKA-në. Ekipi i Medresesë, nën kujdesin e prof. Selatin Mehani, përbëhej nga:

Rijad Beha (11/2)
Muhamed Sinani (11/2)
Amir Demiri (11/1)
Ensar Tahiri (10/1)
Amra Haxhiu (11/3)
Merisa Hoti (11/3)

Ky rezultat është dëshmi e përgatitjes serioze dhe potencialit të lartë të nxënësve të Medresesë në fushën e shahut.



TURNIRI I PINGPONGUT PËR NDER TË 17 SHKURTIT NË PARALELEN E PRIZRENIT



Në kuadër të festimeve për 17 Shkurtin – Ditën e Pavarësisë së Kosovës, në ambientet e paraleles së Prizrenit të shkollës Medreseja Alauddin u organizua një turnir pingpongu me pjesëmarrjen e nxënësve të shkollës amë dhe paraleles së Prizrenit. Garat u zhvilluan në dy kategori: individuale dhe ekipore. Në këtë aktivitet ishte i pranishëm edhe drejtori i Medresesë, z. Fadil Hasani, i cili përgëzoi garuesit dhe i inkurajoi nxënësit për angazhim në aktivitete sportive dhe kulturore.

Në turnir morën pjesë 18 nxënës, të cilët ofruan ndeshjetë forta dhe emocione të shumta gjatë garës. Në kategorinë individuale, podiumin e përbënë:

1. Zejd Uka, klasa 12/5 – Prizren
2. Amar Sagdani, klasa 10/6 – Prizren
3. Omer Demolli, klasa 12/2 – Prishtinë

Ndërsa në garën ekipore, fitues u shpall ekipi i paraleles së Prizrenit, duke treguar nivel të lartë bashkëpunimi dhe teknikë.



MEDRESEJA NË GARAT E VOLEJBOLLIT TË SHKOLLAVE TË MESME TË PRISHTINËS

Nxënësit e Medresesë Alauddin në Prishtinë kanë marrë pjesë në garat komunale të volejbollit, të organizuara për shkollat e mesme të larta të qytetit. Kjo pjesëmarrje është dëshmi e përkushtimit të shkollës për të nxitur zhvillimin fizik dhe shpirtin garues të rinjtë, përveç përgatitjes së tyre arsimore dhe fetare. Ekipi i Medresesë, i përbërë nga nxënës

të motivuar dhe të përkushtuar, tregoi disiplinë, bashkëpunim dhe sportivitet në çdo ndeshje. Pavarësisht rezultatit përfundimtar, pjesëmarrja e tyre është një hap i rëndësishëm në afirmimin e Medresesë si institucion që investon në zhvillimin e gjithanshëm të nxënësve.



MEDRESEJA ZË VENDIN E DYTË NË GARAT E VOLEJBOLLIT TË SHKOLLAVE TË MESME TË LARTA TË PRISHTINËS

Në garat e volejbollit për shkollat e mesme të larta të Prishtinës, të organizuara nga Shoqata e Pedagogëve të Kulturës Fizike dhe Sportit, ekipi i vajzave të Medresesë Alauddin u rendit në vendin e dytë, pas një paraqitjeje të shkëlqyer.

Turneu u zhvillua në ambientet e ish-Gjimnazit "Eqrem Qabej" dhe përfshiu ekipet nga gjashtë shkolla: "Eqrem Qabej", "Sami Frashëri", "Gjin

Gazulli", "Xhevdet Doda", "Ali Sokoli" dhe "Medreseja Alauddin".

Ekipi ynë tregoi aftësi të larta teknike dhe shpirt gare, duke konkurruar me dinjitet ndaj ekipeve të shkollës "Sami Frashëri" dhe "Eqrem Qabej".

Kjo arritje dëshmon angazhimin e vazhdueshëm të shkollës sonë në promovimin e sportit si pjesë e rëndësishme e formimit të plotë të nxënësve.



EKIPI I MEDRESESË SHKËLQEN NË LIGËN E SHKOLLAVE TË MESME TË PRISHTINËS

Medreseja Alauddin po tregon një formë të jashtëzakonshme në Kampionatin e Ligës së Shkollave të Mesme të Larta të Prishtinës, duke regjistruar fitore të rëndësishme dhe duke siguruar kualifikimin në gjysmëfinale.

Kampionati nisi me një fitore bindëse në ndeshjen ndaj ShML “Shtatë Shtatori”, ku ekipi ynë dominoi me rezultat 4:0. Ndeshja u zhvillua në fushën sportive të Medresesë dhe u shqua për paraqitje të shkëlqyeshme të lojtarëve tanë nën drejtimin e profesorit Valon Brajshori. Në të njëjtën ditë u zhvillua edhe ndeshja ndërmjet ShML “Hoxhë Kadri Prishtina” dhe ShM të Mjekësisë “Dr. Ali Sokoli”, e cila përfundoi me rezultat 3:2.

Pas kësaj fitoreje, Medreseja përballoi shkollën “Hoxhë Kadri Prishtina” në një ndeshje të fortë që përfundoi 1-1, por që i siguroi ekipit tonë kualifikimin në gjysmëfinale, falë rezultateve të mëparshme.

Ishte një ndeshje me intensitet të lartë dhe angazhim maksimal, ku u pa qartë përkushtimi dhe disiplina e djemve të Medresesë.

Fitore tjetër e madhe u arrit në ndeshjen kundër shkollës “Dr. Ali Sokoli”, me rezultat 6:3. Ishte një ndeshje e zjarrtë, ku ekipi i Medresesë dominoi nga fillimi në fund me një lojë të organizuar, sulme të sinkronizuara dhe shpirt garues. Edhe pse kundërshtari shënoi tri herë, fitorja jonë ishte e padiskutueshme.

Falë punës së palodhshme të profesorit Valon Brajshori dhe angazhimit të lojtarëve, Medreseja Alauddin tashmë është pjesë e katër shkollave gjysmëfinaliste:

ShML “Hoxhë Kadri Prishtina”

ShML “Eqrem Çabej”

ShML “Ahmet Gashi” dhe

ShML “Medreseja Alauddin”

GROUP B SHML	
1	K.K. PRISHTINA 3 2 3 2 12 3 6 6
2	M. ALAUDDIN 2 2 3 0 10 3 7 6
3	DR. ALI SOKOLI 2 0 3 2 5 8 4 0
4	7 SHTATORI 3 0 3 2 1 11 12 6

JAVA 3
M. ALAUDDIN VS K.K. PRISHTINA
02/06/2025 ORA 14:00
7 SHTATORI VS DR. ALI SOKOLI
02/06/2025 ORA 14:45
VENI, SHËV, M. ALAUDDIN



SPORTISTJA E SHKOLLËS

PORTIERJA PËR KHF PRISHTINA (KLUBI I HENDBOLLIT - FEMRAT)

Balancimi i shkollës me hendbollin mund të jetë i vështirë, por disiplina që kam fituar nga sporti më ndihmon të qëndroj e fokusuar dhe të menaxhoj mirë kohën. Kapërcimi i ndeshjeve të vështira dhe sfidave më ka forcuar karakterin, dhe lidhja me bashkëlojtarët e ekipit më motivon çdo ditë të jap më të mirën time.

Si ekip, kemi arritur shumë suksese, përfshirë tituj kampionë të shumtë, dhe kemi dëshmuar veten si

një forcë dominuese në hendboll. Suksesi më i fundit ishte shpallja kampione para pushimeve verore të vitit 2024 për grupmoshën U16, një arritje që na ka afruar edhe më shumë si ekip dhe na ka bërë të angazhuara për të arritur më shumë.

Desha të ju them se përkushtimi, disiplina dhe besimi në veten tuaj janë çelësi i suksesit, si në sport, ashtu edhe në jetë andaj, mos u dorëzoni në asnjë moment!





Të luaj si portiere për KHF Prishtina ka qenë një sfidë e jashtëzakonshme dhe një përvojë e paharrueshme. Roli im kërkon reflekse të shpejta, vendimmarrje të sigurt dhe aftësinë për të lexuar lojën nën presion. Stërvitjet përfshijnë ushtrime përshkathtësi, reagim të shpejtë dhe zotërimin e strategjive mbrojtëse për të ndaluar goditjet nga çdo kënd."



ANESA GRASHTICA 12/3

ARTI







PIKTORJA E SHKOLLËS

Unë jam Mirjeta Januzi, një artiste e pasionuar dhe e përkushtuar ndaj artit të pikturës dhe shprehjes kreative. Arti për mua është më shumë se një pasion – është një gjuhë për të komunikuar ndjenja, mesazhe dhe vlera që prekin zemrat e njerëzve. Me shumë përkushtim dhe praktikë, kam zhvilluar aftësitë e mia në pikturë, duke eksperimentuar me stile dhe teknika të ndryshme. Puna ime është prezantuar në ekspozita dhe gara të shumta, si në nivel lokal ashtu edhe ndërkombëtar. Kam pasur privilegjin të marr pjesë në një garë ndërkombëtare në Çeki, si dhe në shumë gara dhe ekspozita në vendin tim. Ndër pjesëmarrjet më të rëndësishme për mua përfshihet gara komunale e mbajtur për 17 Shkurtin. Gjithashtu, kam organizuar një ekspozitë

personale dhe kam qenë pjesë e aktiviteteve artistike në Shtëpinë e Kulturës, ku kemi prezantuar punime për 28 Nëntorin, si dhe një projekt të dedikuar ndërgjegjësimit kundër bullizmit.

Përmes këtyre përvojave, arti im është bërë një mjet për të ndarë histori, për të frymëzuar të tjerët dhe për të përcjellë mesazhe që prekin shpirtin. Çdo vepër është një reflektim i përvojave, emocioneve dhe vizionit tim për botën.



NXËNËSJA E DALLUAR RUEJDA BEJTULLAHU

Në Medresenë Alauddin këtë vit u shkrua një kapitull i ri. Shkolla jonë pati një risi të madhe ku për herë të parë u funksionalizua parlamenti i nxënësve. Në krye të tij u zgjodh kryetare Ruvejda Bejtullahu, e cila për herë të parë në historinë e shkollës udhëhoqi njëkohësisht vajzat dhe djemtë.

Rujejda e ka treguar potencialin e saj që në klasë të 10-të, kur bashkë me dy shoqet e saj fitoi vendin e parë në garat e diturisë në nivel shkolle. Po atë vit, ajo u shpall Nxënëse e Dalluar në nivel klase.

Në klasë të 11-të, ajo e vazhdoi këtë ritëm me po të njëjtin përkushtim. Mori pjesë në garat e Kur'anit, ku fitoi vendin e tretë, dhe mori pjese në panairin shkencor të organizuar nga shkolla turke "Kartal Imam Hatip Lisesi".

Këtë vit, si nxënëse e klasës së 12-të, Ruvejda u zgjodh kryetare e shkolles. Me iniciativën e saj u organizua panairi i parë shkencor në shkollë, ku u përfshinë shtatë fusha: biologji, matematikë,

kimi, fizikë, art, teknologji dhe gjeografi. Ishte një ditë që i bashkoi të gjithë nxënësit dhe nxori në pah kreativitetin dhe talentin e tyre.

Përveç rezultateve në shkollë, Ruvejda përfaqësoi medresenë në dy konferenca ndërkombëtare të Model United Nations (MUN) në Stamboll. Në të dytën, ajo fitoi vendin e tretë.

Ajo njihet gjithashtu për aftësitë e saj gjuhësore ku flet gjashtë gjuhë: shqip, anglisht, suedisht, turqisht, gjermanisht dhe pak arabisht.

Në fund të këtij rrugëtimi, Ruvejda u shpall Nxënëse e Dalluar në nivel shkolle, një vlerësim që përmbledh punën, përkushtimin dhe shembullin që ajo ka dhënë në medrese. Ruvejda Bejtullahu mbetet një emër që do të kujtohet gjatë në Medresenë Alauddin, si nxënësjja që tregoi se suksesi arrihet me punë, disiplinë dhe guxim për të bërë ndryshimin.



NXËNËSI I DALLUAR RON BAJOKU

Selam Alejkum

Unë jam Ron Bajoku, nxënës në Medresenë Alauddin. Shkollimi im në medrese është përcjellë me shumë mirësi, çaste të bukura e mirënjohje nga ana e njerëzve të dashur me të cilët na lidhi edukata, dija, por mbi të gjitha, islami. Pasionin tim për poezinë e shfaqja qysh në ditët e mia të hershme në medrese. E kjo u manifestua me pjesmarrjen time të rregullt në programet shkollore si recitator, me promovimin tim si poet e si eseist i ri. Me çrast në garat e poezisë mes shkollave të mesme të Prishtinës më 2023, arrita ta rangojë medresenë në vendin e parë. Ndërkaq profesorët, drejtorinë e shokët i pata përkrahës gjatë gjithë kohës. Gjithashtu për vitin e parë të medresesë u zgjodha nxënësi më i dalluar i klasës ku nuk mungoi edhe shpërblimi nga ana e drejtorisë për këtë arritje. Këto qenë shtysë e fortë që unë të punoj edhe më shumë. Për dy vite morra çmim si recitatori më i mirë i shkollës. Këto më pas do të bëheshin tejet formale në krahasim me surprizën e madhe që më priste! Gara «Selam për ty» që u mbajt

në shkollën tonë e organizuar nga Diyaneti i Turqisë, Bashkësia Islame e Kosovës e drejtoria e shkollës na nxiti mua dhe shokëve të mi që të lexojmë shumë mbi jetën e pejgamberit a.s e pas nënshtrimit të një testi me pyetjet e përzgjedhura rreth librit në fjalë, shpërblimi përrallor për fituesit ishte umre në vendet e shenjta. Elhamdulillah, deshi Allahu dhe unë dola të isha njëri nga fituesit. E bëmë umren me shokë, drejtorinë, disa profesorë dhe udhëheqësit. Mund të paramendohej se çfarë dhurate e vyer ishte kjo! Ky manifestim më mjaftoi mua si dhuratë nga shkolla ime e bekuar. Por jo, sukseset, përkrahjet dhe shpërblimet nuk ndaluan. Në garat e diturisë që mbahen tradicionalisht në medrese arritëm bashkë me shokët e klasës një herë ta zinin vendin e parë e një herë tjetër vendin e dytë. Morrëm pjesë në një panair interesant shkencorë gjithashtu, të organizuar nga vëllezërit-shokët tanë nga Turqia nga shkolla e binjakëzuar Kartal imam Hatip Lisesi. E unë morra pjesë në grupin e kimistëve. Ky panair që frymëzim më pas për dy aktivitete të tjera e shprehje solidariteti mes këtyre shkollave. Njëra që mikpritja në Stamboll të Turqisë nga shkolla në fjalë. Me çrast edhe unë isha njëri nga pjesmarrësit në këtë ekskursion një javor në qytetin e «shtatë kodrave». Momentet e të cilit i mbaj ende të freskëta në memorie. Aktiviteti tjetër ishte organizimi për herë të parë në shkollën tonë i panairit shkencor. Ku pata privilegjin të jem drejtues i grupit të biologëve. Çmimi dhe privilegji final që pata kënaqësinë ta pranoj që mirënjohja si nxënësi më i dalluar i shkollës. Me të cilën ndjeva një krenari dhe gëzim të madh që po e përmbylli udhëtimin tim të bekuar në këtë shkollë në këtë mënyrë. Lus Allahun që ti shpërblejë me xhennet Firdeus shokët e mi, profesorët e mi, drejtorinë e shkollës dhe gjithë stafin për kontributin e tyre, përkrahjen dhe për momentet e ndritura që kalova!



NXËNËSIT DHE NXËNËSET E DALLUARA TË MEDRESESË VIZITOJNË TURQINË

Janari i këtij viti nisi me një përvojë të veçantë për nxënësit dhe nxënëset më të dalluar të Medresesë Alauddin. Të ndarë në dy grupe, djemtë udhëtuan drejt qytetit të Stambollit, ndërsa vajzat drejt bregdetit jugor të Antalyas. Të dyja vizitat ishin të mbushura me mësim, kulturë, histori dhe mikpritje të ngrohtë nga shkollat partnere në Turqi.

Djemtë qëndruan në shkollën “Kartal Imam Hatip Lisesi” në Stamboll, ku u pritën me ngrohtësi nga nikoqirët dhe morën pjesë në aktivitete të ndryshme arsimore. Vizituan klasat, laboratorët, bibliotekën dhe patën rastin të marrin pjesë në një orë të gjuhës angleze ku folën për Kosovën. Përveç pjesës shkollore, vizituan edhe shumë vende me rëndësi kulturore e fetare, si Topkapi, Aya Sofia, Xhaminë Sulltan Ahmet, Çamlıca Camii, Beylerbey Sarayı, si dhe bënë një shëtitje me anije në Bosfor. Një ditë e kaluan edhe në qytetin e Bursës, duke sjellë me vete kujtime të paharrueshme.

Ndërkohë, vajzat kaluan shtatë ditë në Antalya, si mysafire të shkollës “Mahmut Celalettin Ökten Kız Anadolu İmam Hatip Lisesi”. Nën kujdesin e profesorehave Hatixhe Jashanica, Cansu Drangoy dhe Sevdije Arifi Osmani, ato morën pjesë në vizita kulturore dhe historike, si muzeu i Antalyas, lagjja Kaleiçi, kalaja e qytetit, ujëvara e famshme Düden dhe çarshia qendrore. Aty patën mundësinë të shohin nga afër artizanatin dhe traditën turke, si dhe të krijojnë miqësi të reja me nxënëset e shkollës mikpritëse.

Në përfundim të qëndrimit, të dy grupet u kthyen në Kosovë të pasuruar me njohuri, përvoja të reja dhe miqësi të çmuara. Këto eksperiencat janë një hap i rëndësishëm drejt rritjes së nxënësve tanë si individë të dijshëm, të hapur dhe të gatshëm për të përballuar sfidat e së ardhmes.



TRAJNIM KUNDËR BULLIZMIT

Më 30 janar 2025, në Medresenë Alauddin në Prishtinë u mbajt një trajnim me temën “Parandalimi i bullizmit”, i organizuar nga OJQ “Altruisti” dhe i mbështetur nga Komuna e Prishtinës.

Trajnimi u zhvillua në dy grupe, për vajzat dhe për djemtë, dhe u prit me interes të madh nga nxënësit. Ata morën pjesë aktive në diskutime dhe mësuan si të zhvillojnë vetëvlerësimin, të përballen me situata sfiduese dhe të menaxhojnë marrëdhënie të shëndetshme me të tjerët.



NXËNËSIT DHE STAFI DHUROJNË GJAK

Stafi profesional i Qendrës së Transfuzionit të Gjakut nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK) vizitoi Medresenë Alauddin me misionin për të kërkuar vullnetarë nga komuniteti i shkollës për dhurimin e gjakut. Gjatë kësaj vizite u konstatua gatishmëria dhe përkushtimi i stafit dhe nxënësve të shkollës për t’u angazhuar në këtë veprim humanitar. Siç theksohet në Kur’anin Famëlartë:

“Dhe, nëse dikush shpëton një jetë, është sikur të ketë shpëtuar jetën e krejt njerëzve.”

(El-Maide, 32)



VIZITA E DELEGACIONIT TË MEDRESESË ALAUDDIN NË TURQI

Në fillim të janarit 2025, një delegacion i ShML “Medreseja Alauddin”, i udhëhequr nga drejtori prof. Fadil Hasani, realizoi një vizitë pune dhe kulturore në Ankara dhe disa qytete të tjera të Turqisë. Pjesë e delegacionit ishin edhe profesorët: koordinatori i PNF të Prizrenit Almedin Ejupi, Shemsi Rrahimi, Selatin Mehani, Ramadan Uka dhe Driton Arifi. Qëllimi i vizitës ishte forcimi i bashkëpunimit me shkollën vëllazërore Şehit Ömer Halisdemir Imam Hatip Lisesi, ku delegacioni u prit ngrohtësisht nga drejtori Yaşar Keskin, nxënësit dhe stafi i tij. U organizua një program kulturor, vizitë në ambientet shkollore dhe diskutime për bashkëpunime të reja.

Në Ankara, delegacioni u takua edhe me përfaqësues të Ministrisë së Arsimit si z. Mehmet Nezir Gül dhe Dr. Ahmet İşleyen, si dhe me rektorin e Sosyal Bilimler Üniversitesi, Prof. Dr. Musa Kazım Arıcan. Po ashtu, u prit nga Prof. Dr. Enver Osman Kaan, kryetar i Diyanet Akademisi.

Në vazhdim, delegacioni vizitoi qytetet Adana, Gaziantep, Urfa dhe Diyarbakır, ku panë nga afër vende historike dhe fetare. Në Gaziantep, delegacioni u prit nga myftiu lokal, Dr. Hüseyin Hazırlar, në Qendrën e Diyanetit për të Rinj, ku u shkëmbyen përvoja dhe ide për bashkëpunim me Bashkësinë Islame të Kosovës.



“ESEJA MË E MIRË”

GARA NË MEDRESENË ALAUDDIN, NË PARALELEN E GJILANIT

Në kuadër të festimeve për Ditën e Arsimit, Shkolla e Mesme e Lartë “Medreseja Alauddin” në Gjilan organizoi garën e esesë me temën “ESEJA MË E MIRË!”. Ky aktivitet u zhvillua nën udhëheqjen e profesoreshës së Gjuhës shqipe, Sevdije A. Osmani, si pjesë e projektit “Arti është Vlerë”, i mbështetur nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Kosovës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Medresesë Alauddin.

Në garë morën pjesë nxënësit nga Medreseja amë në Prishtinë dhe nga paralelja në Gjilan, duke treguar talent dhe përkushtim në shkrimin e eseve. Pas vlerësimit nga komisioni i përbërë nga profesorët Shahë Memishi (kryetare), Sevdije A. Osmani dhe Xhevdet Rusinovci, u shpallën fitueset:
Vend i parë: **Merjeme Qazimi, klasa X/9**
Vend i dytë: **Emira Mehani, klasa XI/4**
Vend i tretë: **Sumejë Leka, klasa XII/9**



PARLAMENTI I NXËNËSVE MBAN SEANCËN E RREGULLT

Më 29 janar 2025, në ambientet e ngrohta të Medresesë Alauddin, u mbajt seanca e rregullt e Parlamentit të Nxënësve. Nën drejtimin e kryetares së Parlamentit, Ruvejda Bejtullahu, me pjesëmarrjen e anëtarëve të kryesisë, deputetëve dhe përfaqësuesve të të gjitha klasave, seanca u zhvillua në një atmosferë të qetë, konstruktive dhe të frytshme.

Takimi u hap me një fjalë përshëndetëse nga profesori Shkëlzen Hoxha, i cili vlerësoi rolin e Parlamentit si platformë demokratike që nxit pjesëmarrjen, përgjegjësinë dhe bashkëpunimin në mesin e nxënësve. Më pas, u prezantua dhe u miratua logoja zyrtare e Parlamentit të Nxënësve.

Në vijim, Kryesia prezantoi një analizë të hollësishme të aktiviteteve të realizuara gjatë gjysmëvjetorit të parë. Ato u vlerësuan jo vetëm për sasinë, por edhe për cilësinë, ndikimin dhe përfshirjen që kanë sjellë në jetën e shkollës. Pas analizës, u paraqit edhe plani i aktiviteteve për muajt në vijim, i cili u miratua me shumicë votash.

Ky plan përfshinte iniciativat kulturore, sociale, garuese e edukative, me theks të veçantë në angazhimin e nxënësve dhe forcimin e bashkëpunimit mes tyre.

Pjesë e rëndësishme e seancës ishin edhe diskutimet dhe debatet e hapura. Nxënësit ngritën çështje që lidhen me përditshmërinë e tyre në shkollë nga mirëqenia në ambiente, nevojat për mbështetje, propozimet për aktivitete të reja, e deri te përmirësimi i komunikimit ndërshtresor. Deputetë treguan një pjekuri të admirueshme në shprehjen e ideve dhe në dëgjimin e njëri-tjetrit.

Kjo seancë jo vetëm që shërbeu për të reflektuar mbi punën e deritanishme, por edhe për të hedhur bazat e mëtejshme të bashkëpunimit, ku çdo nxënës ndjehet i dëgjuar dhe i përfshirë. Me ide të reja, debat të hapur dhe frymë bashkëpunimi, Parlamenti i Nxënësve vazhdon të jetë një zë i rëndësishëm në jetën e përditshme shkollore, duke e bërë Medresenë një vend edhe më të mirë për të gjithë.



DITA NDËRKOMBËTARE E VAJZAVE NË SHKENCË

Në Medresenë Alauddin – Prishtinë u shënua Dita Ndërkombëtare e Vajzave në Shkencë me një aktivitet të veçantë të zhvilluar në kuadër të lëndës së Gjeografisë, nën udhëheqjen e profesoreshës Zejnepe Abdylit, së bashku me nxënëset e klasave të dhjeta.

Ky aktivitet kishte për qëllim të promovojë rëndësinë e përfshirjes së vajzave në fushat shkencore dhe kreative, përmes:

- Ndërlidhjes së fesë me shkencën, duke theksuar vlerën e dijes në të dyja dimensionet;
- Prezantimit të projekteve 3D dhe punimeve origjinale nga vetë nxënëset;
- Rrëfimeve frymëzuese të ish-nxënëseve të suksesshme në fusha si STEAM-i (Shkencë, Teknologji, Inxhinieri, Art dhe Matematikë);
- Inkurajimit për të ndjekur ëndrrat, për të eksploruar ide të reja dhe për të ndërtuar të ardhmen me dije.

Ky organizim dëshmoi se vajzat janë jo vetëm pjesë aktive e shkollës sonë, por edhe forca lëvizëse e së ardhmes në botën e shkencës dhe dijes.



NXËNËSET E MEDRESESË ALAUDDIN NDËR 10 MË TË MIRAT NË GARËN E ESESË TË QENDRËS "DON BOSKO"

Medreseja Alauddin vazhdon të dëshmojë përkushtimin dhe cilësinë në fushën e arsimit dhe krijimtarisë letrare. Një dëshmi e kësaj është përfaqësimi i suksesshëm në Garën e Esesë, të organizuar nga Qendra Social-Edukative Don Bosko me rastin e Ditës së Shkollës.

Në këtë garë të përvitshme, nxënës nga shkollat e mesme të Prishtinës sfidojnë njëri-tjetrin përmes fjalës së shkruar, duke shpalosur talentin dhe mendimin kritik.

Më 24 janar 2025 u shpallën dhjetë ese më të vlerësuara, ku u renditën edhe dy nxënëset tona të klasës XII/3:

Besira Smajli

Sumeja Tahiri

Ky sukses merr edhe më shumë peshë nga fakti se komisioni vlerësues përbëhej nga profesorë me përvojë, përfshirë edhe profesoreshën tonë të nderuar, Shahë Memishi, e cila këtë herë ishte pjesë e jurisë

Kjo arritje tregon se në Medresenë Alauddin kultivohet talenti dhe dashuria për fjalën dhe krijimtarinë.



PROGRAM FESTIV PËR NDER TË 17 SHKURTIT

Medreseja Alauddin ka qenë një ndër institucionet që, përveç misionit të saj arsimor e fetar, ka luajtur një rol të rëndësishëm në ruajtjen e identitetit kombëtar gjatë viteve të vështira 1981–1999. Në kohën kur liria dhe arsimit ishin të rrezikuar, Medreseja u bë strehë dijesh dhe rezistence, duke edukuar breza të rinj me frymën e qëndresës dhe dashurisë për atdheun. Shumë prej nxënësve dhe mësimdhënësve të asaj kohe morën pjesë aktive në lëvizjen për të drejtat dhe pavarësinë e Kosovës.

Në këtë frymë, edhe këtë vit, për nder të 17 Shkurtit – Ditës së Pavarësisë, Medreseja organizoi një program të pasur kulturor dhe artistik, duke sjellë në vëmendje sakrificat e së kaluarës dhe vlerat për të cilat u bë kjo luftë.

Programi, i moderuar nga nxënësit Enes Islami (12/2) dhe Haxhere Idrizi (12/3), u hap me lexim të ajeteve kuranore nga nxënësi Uveys Pajaziti. Pastaj me nga

një fjalë rasti të pranishmëve iu drejtua kryetari dhe myftiu i Bashkësisë Islame të Kosovës z. Naim Tërnavë dhe drejtori i shkollës, prof. Fadil Hasani.

Koret e shkollës sollën emocione përmes këngëve “Adem Jashari” dhe “Pa duvak s’ka me u ba nuse”. Në vijim u prezantua edhe një video dokumentare, e përgatitur nga nxënësja Sumeja Tahiri (12/3), e cila solli për publikun kujtime të fuqishme nga vitet ’90 dhe përpjekjet për liri.

Ndërsa një pikë veçanërisht mbresëlënëse ishte shfaqja teatrale e shkruar nga prof. Shahë Memishi, që u interpretua nga nxënës të klasave të ndryshme. Programi u përmbyll me këngën “Pavarësia”, e interpretuar nga të dy koret e shkollës – një mbyllje që la pas një ndjesi të thellë krenarie, respekti dhe reflektimi për rrugën e popullit tonë drejt lirisë.



NGA RRËNOJAT E LUFTËS U NGRIT NJË SHTET

Me rastin e 17 Shkurtit – Ditës së Pavarësisë së Kosovës, në amfiteatrin e Medresesë Alauddin në Prishtinë u organizua një program përkujtimor me moton “Nga rrënojat e luftës, u ngrit një shtet.” Aktiviteti, i realizuar nga Departamenti i Gruas, Forumi Studentor Islam dhe vetë Medreseja, solli një kombinim të përmbajtjeve historike dhe artistike – recitime, këngë, dokumentarë dhe pjesë teatrore – që pasqyruan rrugëtimin e popullit tonë nga sakrificat te liria.



MUAJI SHKURT – MUAJI I HIXHABIT

Muaji shkurt, tashmë i njohur në kalendarin ndërkombëtar si muaji i ndërgjegjësimit për hixhabin, është kthyer në një moment të rëndësishëm reflektimi për shumë vajza myslimane në mbarë botën. Në këtë kontekst, u organizua një ligjëratë e veçantë tematike me prof. Hatixhe Jashanica, në ambientet e konviktit të vajzave.

Në ligjëratë u theksua se modestia është shtyllë e edukatës islame, që reflektohet si në sjellje, ashtu edhe në paraqitje. Hixhabi u trajtua si simbol i bindjes

ndaj Zotit, një mburojë shpirtërore dhe shprehje e forcës së brendshme.

Nxënëset morën pjesë aktive në një diskutim të hapur, ku u prekën sfidat bashkëkohore të mbulesës, presionet shoqërore dhe rëndësia e ruajtjes së identitetit.

Ky aktivitet solli reflektim të thellë mbi rolet dhe përgjegjësitë e vajzës myslimane në shoqëri, duke përforcuar vlerat e besimit në jetën e përditshme.



VIZITË NGA PËRFAQËSUESIT E UP-SË

Në ambientet e Medresesë Alauddin, patëm kënaqësinë të mirëpresim studentë përfaqësues nga Universiteti i Prishtinës, të cilët prezantuan fakultetet, programet dhe mundësitë e shumta akademike që ky universitet ofron për maturanët.

Ky prezantim ishte një mundësi e shkëlqyer për nxënësit tanë që të njihen më nga afër me drejtimet e ndryshme studimore dhe të marrin informacione të dobishme për të ardhmen e tyre akademike.



NË PRITJE TË RAMAZANIT TË BEKUAR

Në prag të muajit të Ramazanit, Medreseja Alauddin në Prishtinë u bë vatër e gjallë e ndjeshmërisë dhe reflektimit shpirtëror, përmes dy aktiviteteve të veçanta të organizuara për nxënësit dhe nxënëset e saj.

Për djemtë, në një atmosferë të qetë dhe përkushtuese, hoxhë Isa ef. Tërshani mbajti ligjëratën me temë “Ndikimi i agjërimit të Ramazanit tek muslimani”. Fjalët e tij thelluese ndriçuan rëndësinë e këtij muaji në pastrimin e shpirtit dhe forcimin e lidhjes me Zotin. Programi u pasurua

edhe me interpretimin e ndjerë të ilahisë “Mirë se vjen o Ramazan” nga kori i djemve, duke krijuar një atmosferë përmalluese dhe të përkushtuar.

Ndërsa për vajzat, në një ambient të dekoruar me kujdes dhe plot qetësi shpirtërore, prof. Ilmije Kuqi mbajti një ligjëratë frymëzuese mbi urtësinë dhe begatitë e Ramazanit. Fjalët e saj u pritën me vëmendje dhe ndjeshmëri nga të pranishmet. Programi u përmbyll me interpretimin e ilahisë “Muaji i Mëshirës” nga kori i vajzave, duke e mbyllur gjithë aktivitetin me emocion dhe madhështi.



FRYMA E RAMAZANIT NË SHKOLLËN TONË

Gjatë muajit të bekuar të Ramazanit, në Medresenë Alauddin u organizuan dy iftare tradicionale të ndara për vajza dhe djem, për nxënësit dhe stafin e shkollës.

Një mbrëmje u zhvillua iftari për vajzat, ku ato u

mblodhën së bashku me stafin arsimor dhe edukativ në një atmosferë të ngrohtë dhe të qetë.

Një mbrëmje tjetër, iftari i djemve u organizua në të njëjtin frymë, në një ambient respektues e të përkushtuar.



“ISRAJA DHE MIRAXHI” LIGJËRATË NË MEDRESENË ALAUDDIN

Në kuadër të netëve me rëndësi të veçantë në kalendarin islam, Medreseja Alauddin organizoi një ligjëratë të hapur me rastin e Natës së Miraxhit, e cila shënohet më 27 Rexheb.

Dr. Florentina Tërmkollli, shpjegoi rrugëtimin e Pejgamberit Muhamed a.s. në Isra dhe Miraxh – nga udhëtimi i tij nga Qabeja në Mesxhidul Aksa dhe ngritja në qiejt deri në Sidretul Munteha. Ajo tregoi për takimet me pejgamberët e tjerë dhe theksoi domethënien e këtij mrekullie për besimtarët, veçanërisht për dhuratën e namazit, që u bë obligim në këtë natë.

Kjo ligjëratë nuk ishte vetëm një rrëfim historik, por një ftesë për reflektim të thellë dhe lidhje më të ngushtë me Zotin. Përmes saj, nxënësit kuptuan më mirë se sa e çmuar është kjo lidhje shpirtërore dhe sa shumë mund të fitojmë duke e ruajtur besimin dhe përkushtimin ndaj namazit.

Medreseja Alauddin organizoi një ligjëratë të hapur me rastin e Natës së Miraxhit, e cila shënohet më 27 Rexheb.

Dr. Florentina Tërmkollli, shpjegoi rrugëtimin e Pejgamberit Muhamed a.s. në Isra dhe Miraxh – nga udhëtimi i tij



NATA E KADRIT

MES DRITËS SË KURANIT DHE EDUKIMIT SHPIRTËROR

Nata e Kadrit është më shumë se një moment në kalendarin islam; ajo është një thesar shpirtëror me vlerë më të madhe se një mijë muaj. Në këtë natë të bekuar, zemrat hapen për mëshirën dhe faljen e Zotit, duke na dhënë mundësinë për t'u rikthyer dhe për të forcuar lidhjen me Krijuesin.

Në Medresenë Alauddin, përkujtimi i Natës së Kadrit është një ngjarje me rëndësi të veçantë që i kujton çdo besimtar fuqinë dhe madhështinë e këtij momenti të shenjtë. Përmes recitimeve të Kuranit,

fjalëve frymëzuese dhe interpretimeve artistike, nxënësit e stafi përjetojnë thellësisht mesazhin e kësaj nate, duke u përpjekur të jetojnë me ndërgjegje të plotë dhe përkushtim ndaj besimit.

Kjo natë na fton të reflektojmë mbi rolin jetësor që ka Kurani në udhëzimin tonë dhe mbi vlerën e agjërimit si pastrim shpirtëror. Medreseja, si një qendër dijesh dhe vlera islame, vazhdon të jetë një dritare drejt dritës së besimit dhe edukimit të brezave të rinj.



BOTIME TË REJA NGA PROFESORËT E MEDRESESË ALAUDDIN

“LIBRI ËSHTË DRITË PËR MENDJEN
DHE UDHËRRËFYES PËR SHPIRTIN.”

Në vazhden e angazhimit për avancimin e dijes dhe kulturës, dy profesorë të Medresesë Alauddin kanë sjellë dy botime të rëndësishme që pasurojnë fushat e studimeve islame dhe letërsisë bashkëkohore. Profesori i Tefsirit në Medresenë Alauddin, z. Adnan Simnica, ka publikuar pesë libra të rinj që komentojnë sure të ndryshme të Kuranit famëlartë: Err Rrad, Ibrahim, El Hixhër, Sebee dhe Fatir. Librat janë në format A5 me mbi 280 faqe secili, dhe janë bazuar në një literaturë të gjerë shkencore, duke përfshirë referenca nga periudha të ndryshme historike dhe shkencore. Profesori Simnica ligjëron në Medresenë

që nga viti 2006 dhe kontribuon në përhapjen e njohurive kuranore.

Nga ana tjetër, profesori i gjuhës angleze, Dr. Xhevdet Rusinovci, ka botuar romanin “Politikë në Hënë”, një vepër që sjell një analizë të thellë mbi çështjet socio-politike bashkëkohore dhe sfidon lexuesit për reflektim dhe angazhim qytetar. Disa kopje të librit janë dhuruar për bibliotekën e shkollës sonë.

Këto botime pasqyrojnë përkushtimin e kuadrove të Medresesë në avancimin e dijes dhe kulturës në fusha të ndryshme.



PARALELJA NË PRIZREN E MEDRESESË, ORGANIZON AKTIVITET EKOLOGJIK

Në kuadër të aktiviteteve edukuese dhe vetëdijësuese për ruajtjen e ambientit, Klubi i Ekologëve në paralelen e Medresesë Alauddin në Prizren organizoi një aktivitet të veçantë me moton “Ta mbrojmë mjedisin”. Ky aktivitet, i cili u zhvillua në ambientin e hapur të shkollës dhe më pas në hapësira publike të qytetit, synoi ndërgjegjësimin për rëndësinë e riciklimit dhe ruajtjen e natyrës. Nën përkujdesjen e mësimitdhënësës Besarta Krasniqi dhe me pjesëmarrjen aktive të nxënësve, u prezantuan punime të shumta ekologjike: vazo të krijuara nga shishet plastike, qese të ripërdorshme, objekte artistike nga letër e ricikluar dhe materiale të tjera kreative. Çdo punim bartte një mesazh të

qartë: mjedisi është pasuria jonë e përbashkët dhe ruajtja e tij është përgjegjësi e secilit. Të pranishëm në këtë aktivitet ishin edhe drejtori i shkollës, mr. Fadil Hasani, sekretari Vahid Haxhiu dhe koordinatori i paraleles, Almedin Ejupi, të cilët përgëzuan nxënësit për kreativitetin dhe angazhimin e tyre në këtë nismë të dobishme. Aktiviteti vazhdoi edhe në hapësira të tjera të qytetit të Prizrenit. Nxënësit shpërndanë shishe çeliku për ujë si alternativë ndaj plastikës njëpërdorimëshe, fletëpalosje vetëdijësuese, pastruan një pjesë të shtratit të Lumbardhit dhe vendosën shtëpiza për zogj nëpër lisat e qytetit – një kontribut i gjallë për një të ardhme më të gjelbër dhe të pastër.



DELEGACIONI NGA STAMBOLLI VIZITOI SHKOLLËN TONË

Medreseja Alauddin në Prishtinë ka pasur nderin të presë një delegacion të lartë nga komuna Güngören e Stambollit, i përbërë nga drejtues të arsimit dhe institucioneve arsimore lokale. Në krye të këtij grupi ishin Ferhat Öztürk, drejtor i Drejtoratit të Arsimit në Güngören, Ahmet Koç, drejtues i shkollës së vajzave İTO Imam Hatip Lise, si dhe drejtues të shkollave të tjera të mesme teknike.

Përfaqësuesit e ftuar u pritën nga drejtori i Medresesë, prof. Fadil Hasani, dhe stafi akademik, të cilët shprehën kënaqësinë për vazhdimin e bashkë-

punimit të frytshëm ndërmjet dy institucioneve. Bashkëpunimi me shkollën simotër turke është një urë e rëndësishme e shkëmbimit kulturor dhe edukativ. Për dy vite me radhë, nxënësit e Medresesë Alauddin kanë marrë pjesë aktive në Konferencën ndërkombëtare Model United Nations (MUN), e organizuar nga shkolla turke, duke shkëlqyer dhe fituar certifikata në gjuhët angleze, arabe dhe turke. Kjo vizitë forcon edhe më tej lidhjet ndërkombëtare dhe ofron mundësi të reja për rritje dhe zhvillim për nxënësit dhe stafin e Medresesë.



GARAT E DITURISË 2025

Më 17 prill 2025, Medreseja Alauddin në Prishtinë organizoi me sukses Garat tradicionale të Diturisë, ku morën pjesë nxënësit e tri paraleleve nga Prishtina, Prizreni dhe Gjilani. Ky aktivitet vjetor përfshiu lëndë fetare, gjuhësore dhe shkencore për klasat 10, 11 dhe 12, duke nxitur konkurrencë të shëndetshme dhe përkushtim në dijet.

Garat u zhvilluan në platformën Kahoot në një atmosferë entuziaste dhe të ngrohtë, ndërsa drejtori i shkollës, z. Fadil Hasani, vlerësoi rëndësinë e sfidës intelektuale në rritjen e nxënësve. Programi u moderua nga nxënësja Xhezide Osmani.

Në garë u dalluan më të mirët sipas kategorive:

Klasa 10 – djem:

Vendi i parë: 10/1 Prishtinë

Vendi i dytë: 10/6 Prizren

Vendi i tretë: 10/2 Prishtinë

Klasa 10 – vajza:

Vendi i parë: 10/7 Prizren

Vendi i dytë: 10/4 Prishtinë

Vendi i tretë: 10/3 Prishtinë

Klasa 11 – djem:

Vendi i parë: 11/2 Prishtinë

Vendi i dytë: 11/7 Gjilan

Vendi i tretë: 11/5 Prizren

Klasa 11 – vajza:

Vendi i parë: 11/6 Prizren

Vendi i dytë: 11/3 Prishtinë

Vendi i tretë: 11/8 Gjilan

Klasa 12 – djem:

Vendi i parë: 12/5 Prizren

Vendi i dytë: 12/2 Prishtinë

Vendi i tretë: 12/1 Prishtinë

Klasa 12 – vajza:

Vendi i parë: 12/6 Prizren

Vendi i dytë: 12/7 Prizren

Vendi i tretë: 12/3 Prishtinë

Nxënësi **Visar Rama (12/1)** u nderua për kontributin në krijimin e logos së garave.

Komisioni organizativ, me në krye drejtuesit e shkollës dhe mësuesit përgjegjës, përgëzoi të gjithë pjesëmarrësit për angazhimin dhe suksesin.

Garat e Diturisë mbeten një traditë e çmuar që forcon kulturën e dijes dhe përgatit nxënësit për sfidat e së ardhmes.





NDËRGJEGJËSIM PËR RREZIQET E ARMBAJTJES NË SHKOLLA


Në Medresenë Alauddin në Prishtinë, u zhvillua një ligjëratë e rëndësishme ndërgjegjësuese për nxënësit, në bashkëpunim me Stacionin Policor Veriu. Tema e ligjëratës ishte “Rreziqet e armbajtjes nëpër shkolla” – një çështje shumë aktuale dhe jetike për sigurinë dhe mirëqenien e komunitetit shkollor. Nxënësit e klasave të 10-ta patën mundësinë të informohen thellësisht mbi pasojat ligjore, morale dhe sociale që sjell mbajtja e armëve, municionit apo mjeteve të tjera të rrezikshme në ambientet shkollorë. Zyrtarët e Policisë shpjeguan rëndësinë e parandalimit të këtyre rreziqeve, duke theksuar se çdo situatë e tillë ndikon jo vetëm tek individ, por edhe në mbarë komunitetin e shkollës dhe familjet e tyre.

Gjithashtu u diskutua nevoja për krijimin e një mjedisi të sigurt dhe të qetë, ku nxënësit mund të zhvillohen pa frikë, duke u fokusuar në mësim dhe rritje personale.

Ky ambient i sigurt kërkon bashkëpunimin e të gjithë aktorëve – nxënësve, mësuesve, prindërve dhe institucioneve shtetërore.

Medreseja Alauddin falënderon Policinë e Kosovës për angazhimin dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm në edukimin e të rinjve, duke kontribuar në ndërtimin e një shoqërie më të sigurt dhe më të përgjegjshme. Ky aktivitet është një hap i rëndësishëm në ndërtimin e ndërgjegjes qytetare dhe në parandalimin e sjelljeve që mund të shkaktojnë dëme serioze në ambientet shkollorë dhe më gjerë.





PANAIRI SHKENCOR

Më 23 prill 2025, oborri dhe fusha sportive e Medresesë Alauddin në Prishtinë u kthye në një oazë të shkencës dhe kreativitetit, me organizimin e Panairit Shkencor 2025 – një ngjarje që pasqyroi pasionin dhe përkushtimin e të gjithë komunitetit shkollor.

Ky panair, i cili përfshiu jo vetëm nxënës dhe mësime nga dy paralelet e Medresesë në Prishtinë dhe Prizren, por edhe vizitorë nga shkolla të tjera të mesme të Prishtinës e më gjerë, ishte një mundësi e shkëlqyer për të shfaqur njohuritë, ide kreative dhe eksperimente të ndryshme në fusha të ndryshme të dijes. Në mesin e shkollave të ftuara ishin ShML “Sami Frashëri”, “Gjin Gazuli”, “Xhevdet Doda”, “Ahmet Gashi” dhe të tjera, që i dhanë ngjyra dhe dinamizëm këtij eventit.

Hapja solemne e panairit u bë nga drejtori i shkollës, prof. Fadil ef. Hasani, i cili përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe theksoi rëndësinë e promovimit të shkencës dhe bashkëpunimit ndërdisiplinor si shtyllë të zhvillimit akademik dhe personal të nxënësve.

Panairi u zhvillua në tendat e organizuara në fushën sportive të shkollës, ku ekspozoheshin projektet e ndryshme të nxënësve në lëndë si kimi, fizikë, biologji, teknologji, matematikë, gjeografi dhe art.

Panairin shkencor e nderoi me vizitën e tij drejtori i Drejtorisë të Arsimit të Prishtinës, z. Samir

Shahini me bashkëpunëtorë.

Përveç këtyre, vizitorët patën mundësinë të shijojnë edhe aktivitete artistike dhe lojëra kreative, të organizuara nga grupet e veçanta të nxënësve, duke i dhënë panairit një atmosferë të gjallë dhe të ngrohtë. Përgatitja dhe organizimi i këtij eventi madhor nuk do të kishte qenë i mundur pa përkushtimin e veçantë të organizatorëve kryesorë: kryetares së Këshillit të Nxënësve, Ruvejda Bejtullahu nga klasa 12/4 dhe nënkryetarit Enes Islami nga klasa 12/2. Ata udhëhoqën me pasion ekipet e ndryshme dhe bashkëpunuan ngushtë me mësime për të garantuar që çdo detaj të ishte i përgatitur me kujdes dhe profesionalizëm.

Në fund të ditës, drejtori i shkollës shpërndau mirënjohje për grupet shkencore, organizatorët dhe mësime, duke falënderuar secilin për kontributin dhe përkushtimin e treguar.

Panairi Shkencor 2025 është një dëshmi e fuqishme e punës së palodhshme të nxënësve dhe stafit, si dhe një hap i rëndësishëm në nxitjen e interesit për shkencë dhe teknologji, bashkëpunim dhe kreativitet në Medresenë Alauddin. Ky aktivitet jo vetëm që pasuroi dijen e pjesëmarrësve, por edhe forcoi lidhjet mes shkollave dhe komuniteteve, duke u kthyer në një traditë që premtonte të rritet dhe të pasurohet çdo vit.







DUAJA E HATMES – GJENERATA E 24-TË E VAJZAVE TË MEDRESESË ALAUDDIN

Më 29 prill 2025, në amfiteatrin e Medresesë Alauddin u zhvillua ceremonia madhështore e Duasë së Hatmes për vajzat maturante të gjeneratës së 24-të.

Kjo ngjarje përfaqëson një moment të rëndësishëm në jetën e tyre, ku përmbyllet një etapë e gjatë e përkushtimit ndaj Kur'anit Famëlartë dhe vlerave shpirtërore që ai përçon.

Ceremonia u moderua nga Ruvejda Bejtullahu, ndërsa të gjitha maturantet recituan ajete kuranore me përkthim, duke krijuar një atmosferë reflektimi dhe qetësie.

Duanë përfundimtare lexuan me emocion Esra Bytyqi në gjuhën arabe dhe Sumeja Tahiri në shqip.

Fjalën përshëndetëse e mbajti drejtori prof. Fadil ef. Hasani, i cili theksoi rëndësinë e ruajtjes së lidhjes me Kur'anin dhe jetës me dritën që ai dhuron.

Në fjalët e tyre, Ahmet ef. Sadriu, Prof. Valbona Asllani dhe Prof. Shkëlzen Hoxha u ndalën jo vetëm te arritjet akademike, por edhe tek edukimi shpirtëror që këto vajza morën gjatë viteve në Medrese.

Për përkushtimin dhe arritjet e tyre, u ndanë mirënjohje për nxënëset më të dalluara:

Ruvejda Bejtullahu (12/4), nxënësja më e dalluar në shkollë

Sumeja Tahiri (12/3), e dyta në nivel shkolle

Hilale Avdyli (10/3), Rejana Çunaku (10/4), Leijla Dukaj (10/5), Daria Smajli (11/3), Ema Bajgora (11/4), Besira Smajli (12/3) dhe Sumeja Ahmeti (12/4) – nxënëset më të dalluara në nivele klasash

Gjithashtu, u dhuruan mirënjohje për kontributin në aktivitete të ndryshme:

Arti: Xhezide Osmani (12/4), Haxhere Idrizi (12/3), Esmat Sylejmani (12/3), Esra Bytyqi (12/4)

Informimi: Sara Kurtolli

Redaksia “Drita e Kuranit”: Lumnie Sadiku (12/4)

Kori i Shkollës: Erda Musliu (12/4), Vlera Zeneli (12/4), Amera Nika (11/4)

Disiplina dhe rendi: Alejna Rexhepaj

Etika dhe sjellja shembullore: Rumejsa Merxha

Kjo ditë e paharrueshme u përjetua me emocion dhe krenari nga familjarët, stafi dhe mysafirët, duke shënuar një fund të bukur dhe një fillim të ri për vajzat që tashmë mbajnë në zemër dhe shpirt Kur'anin si dritën e jetës.





RUVEJDA BEJTULLAHU 12/4



SUMEJA AHMETI 12/4



SUMEJA TAHIRI 12/3



BESIRA SMAJLI 12/3



EMA BAJGORA 11/4



DARIA SMAJLI 11/3



LEJILA DUKA 10/5



REJANA ÇUNAKU 10/4



HILAË AVDYLI 10/3

DUAJA E HATMES – GJENERATA E 58-TË E DJEMVE TË MEDRESESË ALAUDDIN

Më 30 prill 2025, në ambientet e Medresesë Alauddin në Prishtinë u zhvillua ceremonia madhështore e Duasë së Hatmes për maturantët e gjeneratës së 58-të të paraleles së djemve. Kjo ngjarje shënoi përmbylljen e një faze të rëndësishme arsimore dhe shpirtërore, duke reflektuar përkushtimin e tyre ndaj Kur'anit Famëlartë dhe vlerave të tij.

Ceremonia u moderua nga Visar Rama (12/1), ndërsa maturantët lexuan ajete kuranore, duke krijuar një atmosferë respekti dhe reflektimi. Duanë përfundimtare e recitoi me emocion Ron Bajoku nga klasa 12/2.

Fjalën përshëndetëse e mbajti drejtori z. Fadil Hasani, i cili theksoi rëndësinë e vazhimit të rrugës me dritën e Kur'anit. Në fjalët e tyre, profesori i Kuranit, z. Ekrem Maqedonci, dhe përfaqësuesi i prindërve, z. Fatmir Smajli, nënvizuan vlerën e përkushtimit shpirtëror dhe akademik të maturantëve.

Në nder të arritjeve të tyre, u ndanë mirënjohje për nxënësit më të dalluar:

Nxënësi më i dalluar në nivel shkolle: Roni Bajoku (12/2)

Përfaqësimit dinjitoz i Medresesë: Shpëtim Smajli (12/1)

Nxënësit e dalluar në nivel klasash: Jasir Cakolli (10/1), Engjëll Stublla (10/2), Anik Banjska (11/1), Uvejs Beqiri (11/2), Visar Rama (12/1), Ensar Veseli (12/2)
Gjithashtu, mirënjohje u dhanë për kontributet në aktivitete të ndryshme:

Përfaqësimit në gara të Kuranit:

Ensar Januzaj (12/1)


Kori i shkollës: Riad Avdiu (12/1), Nderim Alshiqi (12/2), Amar Tërnavë (11/1)

Për angazhim të vazhdueshëm si nënkryetar i KNSh-së: Enes Islami (12/2)

Disiplinë dhe rend: Enes Hoti (12/1)

Informim, dizajn, etikë dhe sjellje shembullore: Visar Rama (12/1)

Ceremonia u përmbyll me emocione dhe krenari nga prindërit dhe familjarët, të cilët panë frytin e përkushtimit të bijve të tyre gjatë viteve në Medrese. Ky ishte një moment i paharrueshëm që shënoi suksesin, sakrificën dhe dashurinë për dijen dhe fenë të gjeneratës së 58-të të djemve të Medresesë Alauddin.





RON BAJOKU 12/2



ENSAR VESELI 12/2



VISAR RAMA 12/1



SHPËTIM SMAJLI 12/1



UVEJS BEQIRI 11/2



ANIK BANJSKA 11/1



ENGJËLL STUBLLA 10/2



JASIR ÇAKOLLI 10/1

MEDRESEJA ALAUDDIN NË TRAJNIM PËR LEADERSHIP

Nxënësit Enes Islami, Ruvejda Bejtullahu, Besira Smajli, Shpëtim Smajli dhe Ron Bajoku morën pjesë në një trajnim të veçantë për leadership, të organizuar nga Global Learning Lab – një organizatë e njohur për zhvillimin e të rinjve dhe përgatitjen e tyre për sfidat e së ardhmes.

Ky trajnim kishte për qëllim zhvillimin e aftësive udhëheqëse përmes aktiviteteve interaktive, punës në grupe dhe ushtrimeve praktike.

Gjatë trajnimit, nxënësit patën mundësi të përfshihen në diskutime rreth rolit të liderit në komunitet, mënyrave të ndërtimit të besimit dhe komunikimit efektiv, si dhe rëndësisë së përgjegjësisë qytetare.

Përveç zhvillimit personal, trajnimi ofroi edhe hapësirë për reflektim mbi ndikimin që mund të ketë një lider i ri në shkollë, në shoqëri dhe në jetën publike. Përvoja e fituar gjatë këtij programi i ka pajisur pjesëmarrësit me njohuri dhe vetëbesim për të vepruar si agjentë ndryshimi në mjediset e tyre.



DELEGACIONI I NGA LONDRA VIZITON MEDRESENË ALAUDDIN

Më 3 maj 2025, Medreseja Alauddin në Prishtinë mirëpriti një delegacion të lartë nga UK Albanian Muslim Community and Cultural Centre – Xhamia e Shqiptarëve në Londër. Drejtori Fadil ef. Hasani i njohu mysafirët me historikun dhe arritjet e medresesë.

Delegacioni përbëhej nga figura kyçe të komunitetit shqiptar në Londër, ndër të cilët Zymer Salihi – Myfti, Ayad Al Tuhafi – arkitekt, dhe të tjerë. Në një atmosferë të ngrohtë u diskutua për bashkëpunimin dhe mbështetjen e edukimit islam.

Kjo vizitë shënoi një hap të rëndësishëm për thellimin e lidhjeve dhe bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e arsimit islam.



VIZITË ZYRTARE NË MEDRESENË “ISA BEU” NË SHKUP

Mbi 120 maturantë të Medresesë Alauddin në Prishtinë, së bashku me stafin arsimor, realizuan një vizitë zyrtare në Medresenë “Isa Beu” në Shkup. Delegacioni, i udhëhequr nga drejtori Mr. Fadil Hasani, u prit ngrohtësisht nga drejtori Dr. Islam Islami dhe stafi i institucionit mikpritës.

Gjatë vizitës u shkëmbyen përvoja dhe u diskutua për bashkëpunime të ardhshme. Maturantet e

paraleles së vajzave u mirëpritën me përzemërsi nga bashkëmoshataret e tyre në Shkup, duke ndarë momente të veçanta dhe reflektime mbi rrugëtimin e tyre shkollor.

Vizita u përmbyll me një takim me Kryetarin e BFI-së, Shaqir ef. Fetaj, i cili vlerësoi këtë nismë dhe rolin e medreseve në edukimin dhe forcimin e vlerave islame në shoqëri.



GARAT BALLKANIKE TË KURANIT 2025

Nga 9 deri më 11 maj 2025, në Prishtinë u zhvilluan Garat Ballkanike në memorizimin e Kuranit, me pjesëmarrës nga vende të ndryshme të Ballkanit dhe Evropës. Nxënësit e Medresesë Alauddin treguan një performancë të shkëlqyer dhe fituan tri çmime të rëndësishme në kategori të ndryshme.

Në kategorinë e katërt (2 xhuz'a përmendësh), Daria Smajli nga klasa 11/3 u shpall fituese e vendit të parë,



ndërsa Hamza Arslani nga klasa 12/1 mori vendin e dytë. Në kategorinë e dytë (10 xhuz'a përmendësh), Hana Maloku nga klasa 12/9 arriti vendin e tretë.

Përveç fituesve, shumë nxënës të tjerë të Medresesë Alauddin morën pjesë dhe konkurruan me sukses në garë, duke dëshmuar përkushtimin e tyre ndaj Kuranit dhe përgatitjen e mirë. Po ashtu, disa ish-nxënës të shkollës arritën rezultate të larta, duke nderuar traditën e medresesë në këtë fushë.

VIZITA STUDIMORE E KLASËS 11/3

Klasa 11/3, më e dalluara për vitin shkollor 2023/2024, realizoi një vizitë dyditore studimore në Shqipëri dhe Mal të Zi, nën drejtimin e stafit dhe drejtorit prof. Fadil ef. Hasani.

Nxënëset vizituan vende historike dhe fetare si Shëngjini, Shkodra (Xhamia e Plumbit, Xhamia "Ebu Bekër"), Medresenë "Mehmed Fatih" në Tuz, Qendrën Islame dhe qytetin e vjetër të Borit, si dhe Ulqinin, ku u pritën nga Isa ef. Alosi.

Udhëtimi përfundoi në Shirokë pranë Liqenit të Shkodrës, duke sjellë përvoja dhe kujtime të vlefshme për nxënëset.



VIZITË STUDIMORE NË FERRONIKEL

Në kuadër të aktiviteteve edukative, 38 nxënësë të Medresesë Alauddin, nën udhëheqjen e profesoreshave Ardiana Bytyqi, Hatixhe Jashanica dhe Diona Berisha, realizuan një vizitë studimore në fabrikën “NeëCo Ferronikeli”.

Gjatë vizitës, nxënëset u njohën me procesin industrial të përpunimit të nikelit, teknologjinë që përdoret dhe ndikimin ekonomik e mjedisor të kësaj industrie. Stafi i fabrikës ndau me profesionalizëm njohuri të vlefshme, duke e bërë këtë përvojë të pasur dhe frymëzuese për të ardhmen e tyre.



SHËTITJE KULTURORE NË KOSOVË



Më 23 maj 2025, nxënësit e klasave të 10-ta dhe 11-ta të Medresesë Alauddin zhvilluan një shëtitje edukative në vende me rëndësi natyrore e historike të Kosovës.

Djemtë vizituan Shpellën e Gadimës, Prevallën dhe Prizrenin, ndërsa vajzat udhëtuan drejt Prekazit, Istogut, Pejës, Burimit të Drinit të Bardhë dhe Gurit të Zi.

Kjo ditë ishte e mbushur me përjetime të bukura dhe mësimë të vlefshme për nxënësit tanë.



PROGRAM LAMTUMIRËS PËR GJENERATËN E 24-TË

Në një atmosferë të ngrohtë dhe me shumë emocion, u mbajt programi tradicional i lamtumirës për maturanet e Medresesë Alauddin – gjeneratën e 24-të. Programi nisi me lexim Kurani nga nx. Anika Saiti dhe fjalë përshëndetëse nga drejtori prof. Fadil ef. Hasani.

Kujdestarët, prof. Shkëlzen Hoxha dhe prof. Valbona Asllani, ndanë mesazhe përkushtimi dhe urimesh, ndërsa kryetarja e shkollës, Ruvejda Bejtullahu, solli një fjalim emocional për përvojën e maturanëve.

Momente të veçanta ishin monologu “Dje fazanka, sot maturanë” nga Emira Mehani dhe interpretimet humoristike të Sherife Rexhës dhe Esmë Selmanit. Gjatë programit u shfaqën video dhe foto të kujtimeve të viteve shkollë, ndërsa nx. Melika Muahxhiri dhuroi dhurata simbolike për maturanet. Në përfundim, maturanet falënderuan Medresenë për mbështetjen dhe formimin që u dhanë gjatë viteve.



DY MBRËMJE PLOT EMOCIONE, KUJTIME DHE MIRËNJOHJE – LAMTUMIRA E GJENERATËS SË 24-TË DHE 58-TË

Në një ambient solem dhe të ngrohtë, u organizua mbrëmja e lamtumirës për djemtë e gjeneratës së 58-të të maturantëve të Medresesë Alaudin Edhe vajzat maturante të gjeneratës së 24-të përjetuan një mbrëmje të paharrueshme, të mbushur me emocione dhe krenari. Mbrëmja nisi me një drekë solemne ku morën pjesë drejtori prof. Fadil ef. Hasani, Myftiu i Kosovës Naim ef. Tërnavë me bashkëpunëtorë, staf pedagogjik dhe nxënëset.

Programi vijoi me lexim Kur’ani, fjalime përshëndetëse, poezi dhe video përplot kujtime nga jeta në medrese. Emocionet kulmuan me monologun e ndjerë dhe filmin përmbledhës për rrugëtimin e vajzave gjatë tri viteve. Medreseja Alaudin është krenare për çdo maturant e maturante që lë gjurmë në këtë institucion të dijes dhe vlerave.



PSE IKE ?

Pse ike e pse na le?

*A e di se pa ty jemi të zhytur nën dhe,
plotë gjynahe të mbuluar t'katandosur e t'hutuar,
shumë ndaj sprovav të paduruar, ndaj dynjas të
mashtruar.*

*Pres iftari me fillu,
s'dul kërkush me tregu,
a thu vallë ku kanë shku,
Ramazani ish largu.*

*Me zemër të dëshpruar,
mirëpo me shpresë të pa shuar,
veprat e mira, Zot të na i pranosh,
nga Xhehnemi t'na shpëtosh.*

*Edhe një gjë du me kërkju,
para Zotit me dëshmu,
Veç për Atë kam agjëru që Xhenetin me fitu.*



GAZA

*Mosni oj nëna, oj motra
Ndër lotë mos thurni mallkime
Mosni o vëllezër, që gulçoni
Ah ky vëlla i juaji s'u dha asfarë ndihme
Dhe ju pleq që me mundime arritët pleqërinë
Gjyshrit e mi jeni
Nipin mos e shani se s'ju erdhi në ndihmë*

*Vëllaçko, motërzë!
Mos qani të ëmblit e mi
Vëllai s'bëri gjë për ju
Ah ç>vëlla qenka ky
Se juve ndihma do tju vijë
Allahu do tju ndihmojë
Allah, të lutem, kur momenti të vij
Aty në mejdan edhe unë të qëlloj
Mi idhto në zemër ata batakçinjtë
Ata rrenacakët e shpirtkëqinjtë
Që frikësohen e dridhen si purtekë
Këmba në një grusht toke dot s'u shkelë
Veç prej së largu siç bën ndonjë frikacak
Vrasin me bomba njerëz pa hesap
Të mallkuar jeni, në zemrat tuaja ka zënë rrënjë
frika*

*O vrasës të pejgamberëve
O njerëz të pështirë
O të pa karakter
S'i gjen dot ndonjë cilësi të mirë
Dhe ti o kryederr
I baltosur në llucën tënde të ndyrë
Të ardhtë vdekja në llucë
E pastaj... e di ti shumë mirë!
Mos u fshehni pas sinagogës
Kur shkoni në tempull të demagogës
Sionistë a si dreqin u thonë
Në ç'fe jeni, dikush a na tregon?
ÇQë çatë kraharorin e çdo ndjenjë nga zemra hoqët
Ç>mendje keni, ç'mendoni?
Nëse veç keni mend e mendoni...*

SON KEZ ÇALDIĞINDA ZAMANIN ZILI (MEDRESE İÇİN VEDA ŞIIRI)

Üç yıl kelebek gibi hızla geçti,
Kalpten okuduğumuz bir kitabın sayfaları gibi,
Medresemiz — ışığın yuvası,
Bize ilimle, sevgiyle, nurla öğretti her şeyi.

Her sabah kahkahalarla doluydu,
Kapısı iyilik kokusuyla açılırdı,
Sırada sadece sessiz öğrenciler değildik,
Aileydik — kalpten, şaka ile, bilgiyle birlikteydik.

Hocalarımız, sadece öğretmen değillerdi,
Karanlıkta birer ışık oldular bize,
Sadece kitaplarla değil, açık yürekle,
Bize inancı, sabrı, tertemiz bir ruhu öğrettiler.

Her derste unutulmaz anlar yaşandı,
Bir espri, bir gülüş hiç bitmeyen,
Zor sınavlarda, bilmesek bile,
Umutla birlikte başardık, hiç sönmeyen
tebessümlerle.


Ve şimdi zamanın zili son kez çaldığında,
Biliyoruz ki gitmiyoruz — yanımızda
götürüyoruz,
Bu okuldan bir parçayı, her ders ve her hatırayı,
Kalbimizde sonsuza dek yaşayacak gerçek bir
sevdayı



DREDHËZA E MALLIT

Dredhëza ime e kuqe
Më e ëmbla frutë e pyllit
Në pyllin e ngatërruar mezi të dalloj
Por, kur të thur vargje dashurie
Ti skuqesh
E unë që larg të diktoj
Morra rrugën
Që në këtë vend ushtar të qëndroj
Më thanë, pak kush del i gjallë
Askënd s>desha ta dëgjoj
Vazhdova gjersa uria e lodhja
Në hardhinë tënde më dërgoi
Që kur të shijova, më as s>pash as s>dëgjova
Ashtu bëre edhe ti
U skuqe e tëra
Edhe tash të shijoj
E njëta ndjenjë si herën e parë
Fytyrën tënde të kuqe
Zemra ime përherë ka mall

Ron Bajoku



KËSHILLA TË ARTA NGA PROFESORËT

*“Mos prit që rruga të bëhet e lehtë, përpigu që ti të bëhesh më e fortë,
gjithherë duke u mbështetur në të Madhin Zot”*

Shkëlzen Hoxha

*“Do ta ndryshoni gjendjen vetëm nëse jeni të gatshëm ta ndryshoni vetveten!
Mësimet e Medresesë janë manuali më i vlefshëm për t’ju udhëhequr në këtë
rrugëtim-drejt zhvillimit personal, professional dhe shpirtëror. Mos harroni:
Një femër e edukuar dhe e shkolluar është themeli i një shoqërie të ndriçuar.”*

Valbona Asllani

*Urtësinë, mësimet, edukatën dhe parimet që morët në Medrese, le të jenë
postulate mbi të cilat hapëroni drejtë ardhmërisë suaj. Shkollën e perfunduat
sot por mësimi vazhdon gjatë gjithë jetës.*

Ekrem Maqedonci

*“Bekimin më madhështor nga Zoti yt e posedon,
nëse në jetën tënde vetëm kënaqësinë e Tij e kërkon”.*

Driton Arifi

“Allahu xh.sh., jau baftë rrizk hajrin në të dy botët, Amin!”

Adnan Simnica

*“Dy veta me dije, devocion dhe vizion mund të ndryshojnë shumë më shumë
se një stadium me duartrokitës. Ti ke roll!”*

Muharrem Tërrnava

*“Pavarësisht të gjithave, qëndrimi pozitiv dhe i fuqishëm do ta bëjë individin
tërheqës të njerëzve dhe të suksesit.”*

Xhevdet Rusinofci

“Bëhu ndryshimi që e dëshiron për botën”

Hysni Beka

*“Për cdo gjë ka kohë, vetëm për mësim kurrë nuk ka kohë, ndërsa vjedhësi më
i madh i kohës është pavendosmëria. Suksesi i vërtetë është të kapërcesh
frikën e dështimit!”*

Hatixhe Jashanica

*“Mbajeni mend gjithmonë! Jeta nuk është garë, është udhëtim i bukur. Çdo
përpjekje është një hap më afër së nesërmes. Mos hiqni dorë nga vështirësitë,
sepse forca lind në përballje! Unë besoj te ju: vazhdoni,
ëndërroni dhe mos u ndalni së mësuari!”*

Zysha

Fjalët e fundit nga maturantët 12/1

Abdullah Hyseni:

“Kush mbështet tek Allahu, nuk ka për t’u zhgënjyer kurrë.”

Ahmed Latifi:

“Mos e mbulo paaftësinë me petkun e urtësisë.”

Aid Krasniqi:

“Kur planifikon shumë, ndodh që të harrosh të gëzohesh me atë që ke.”

Almir Krasniqi:

“Tek prisnim të piqeshim kushtet, na u kalbën dëshirat.”

Amar Ademi:

“Ajo që nuk vret, na bën më të fortë.”

Edin Miftari:

“Don’t compare yourself to others, comparison is the thief of joy.”

Enes Hoti:

“Together forever.”

Enes Obërtinca:

“When the beauty begins from the heart, the deaf will hear and the blind will see.”

Ensar Januzaj:

“Mos ndalo kur je i lodhur, ndalo kur të kesh mbaruar!”

Erit Krasniqi:

“Pa koment.”

Ermal Latifi:

“Nëse më detyron të zgjedh mes teje edhe meje, zgjidhja është e lehtë.”

Fidan Desku:

“Bota është një hije që po kalon. Mos u bëj rob i saj!”

(Uthmani r.a)

Hamza Arslani:

“Nëse dëshiron të dish pozitën tënde tek Allahu,

shiko se me çka je i angazhuar.”

Haris Halimi:

“Shpresa nuk vdes kurrë.”

Jamin Miftari:

“Vepro sipas ligjeve të Allahut dhe asnjëherë nuk do humbësh.”

Kleit Morina:

“Me fjalë e nxjerr kryt e fjalët i nxjerr me kry.”

Leonit Hasani:

“Zoti është gjithmonë me ty, mos ki frikë.”

Melos Surkishi:

“People come and go, that’s life.”

Muhamed Haziri:

“Kujtimet e mira i kam pas kur kam qenë i vogël.”

Omer Dalipi:

“Jeta është një udhëtim, jo një garë – gëzo çdo hap, mëso nga çdo sfidë dhe jeto me pasion.”

Omer Imer:

“Dija është më e vlefshme se pasuria, sepse dija të mbron ty, ndërsa pasurinë duhet ta mbrosh vetë. Dija shtohet kur e shpërndan, ndërsa pasuria pakësohet kur e ndan.”

Riad Avdiu:

“Suksesi nuk varet nga rezultati, por nga angazhimi.”

Sead Veseli:

“Bëhu i drejtë, edhe nëse është kundër interesave të tua.” (Omer ibn Hattabi r.a)

Fjalët e fundit nga maturantët 12/2

Abdurahman Hasangjekaj:

“Shpresa vdes e fundit, andaj mos u ndal së shpresuari dhe mos i le të tjerët të ta humbin shpresën.”

Ahmed Bajrami:

“Never forget where you came from and never lose sight of where you are going.”

Amar Isufi:

“Ta dini se jeta në këtë botë nuk është tjetër veçse lojë, dëfrim e zbukurim...” (El Hadid, 20)

Amir Sogojeva:

“Humbje e vërtetë është ta jetosh jetën tënde pa namaz.”

Amër Begolli:

“Send him 3–2 years Dagestan and forget.”

Andi Jashari:

“Success is not measured by wealth, but by the state of one’s heart and actions.”

Bajram isoka:

“Nuk ka besuar askush përderisa të mos e dojë për vëllaun e tij atë që do për veten e tij.” (Muhamedi s.a.v.s.)

Enes Bytyqi:

أن تضيء شمعة صغيرة خير لك من أن تنفق عمرك تلعن الظلام

Enes Hoti:

“Doot format.” (Rr. Aliu)

Enes Islami:

“Shqipëria e shqiptarëve, vdekje tradhtarëve!”

Ensar Haradinaj:

“Paragjykimet janë ato që budallenjtë përdorin për arsye.” (Volteri)

Ensar Veseli:

و من سلك طريقا يلتمس فيه علما، سهل الله له طريقا إلى الجنة
(Hadith)

Ibrahim Hasangjekaj:

“She might not love you but a Siooorr will.”

Ibrahim Krasniqi:

“Nëse edukimi shkollor i bën njerëzit të punojnë për para, atëherë edukimi financiar i bën paratë të punojnë për ta.”

Muhamed Aliu:

“Përcaktimi i qëllimit është fillimi i arritjes.”

Ron Bajoku:

“Shtyje veten drejt më të mirës edhe pse dhemb pak. Nënshtrou Allahut, ke për t’u çuditur më pas.”

Seid Hondozi:

“Bëj atë që duhet, jo atë që duash.”

Sejjid Idrizi:

“Kurani është shërim për zemrën, por ai nuk mund të shërojë një zemër që nuk e pranon atë.”

(Ibn Kajjim)

Shpëtim Smajli:

“Ji modest, do jesh si diell, shfaqesh në ujë por je lart në qiell.”

Sudejs Mehmeti:

“Dituria pa vepra është si një pemë pa fruta.”

(Imam Ebu Hanife)

Suhejb Tolaj:

“Njeriu duhet të argumentojë së pari dhe pastaj të gjykojë, jo të gjykojë dhe pastaj të argumentojë.”

Uveys Pajaziti:

“Ma mirë se mirë ska! Ma mirë se me ia ditë hallin vetit ska!”

Uveys Shatri:

“Better to cheat than to repeat.”

Veli Hasani:

“Pozitë pa pushtet apo pushtet pa pozitë.” (B.J.)

Visar Rama:

“You don’t need more TIME, you need more FOCUS.”

Fjalët e fundit nga maturantët 12/3

- Ajla Cakiqi- *“Na jepni mundësinë me u shpreh , Allahu ju nderoftë”* -A.Simnica
- Alejna Rexhepaj- *«Kushti i parë për sukses është vendosmëria»* - E.Maqedonci
- Amina Osmani- *“Edhe veprat e rëndomta, nijeti i bën të mëdha”*- E.Maqedonci
- Anesa Grashtica- *«Zoti është nalt, e ti po don mi zgjedh problemet me njerz a ?»* A.Simnica
- Anesa Krasniqi- *«Mos guxo me marr çekanin e gjykatsit kur flet per sahab»*-S. Ahmeti
- Anila Berisha- *“Durimi të çon në shpëtim”* -D. Arifi
- Belkisa Myrta- *«Nuk e dime nimetin e Islamit derisa tballafaqohemi me prova, qashtu qysh nuk e dime nimetin e syve derisa ti humbim ata»* - Sh.Hoxha
- Besira Smajli- *«Çdo gjë që del prej Kuranit është e bereqetshme»* - Sh.Hoxha
- Elma Kameri- *“Ah um fal se un nuk nij mir me syza»* -Rr. Aliu
- Elmedina Halilaj- *“Nuk ka numër n’matematik për me shpreh vleren e namazit”* Rr.Aliu
- Elsa Berisha- *“I merr era ato vepra që sinqeriteti ju mungon”* -D.Arifi
- Emira Gashi- *“E mira brenda teje është ni dritë e madhe, e dikush e ka dhez ni qiri t’vogël e po thot “Une t’boj keq ty”*-A.Simnica
- Erda Bislimi- *“Nëse pritni n’jetë sene ideale,jeni tu jetu jetë imagjinare”* -J.Çunaku
- Erisa Begolli- *“The best way to predict the future is to create it”* -Xh. Rusinovci
- Esmat Sylejmani- *“Once again the world has proven anything you can do,I can do better”*- B.Waldorf
- Esmat Simnica- *«Çelësi për çdo gjë është Allahu»* -A.Simnica
- Fatjona Gashi- *“Ae din që Ai Zoti qe i lutësh mëngjes e mbrëmje e ka qdo gjë mes dy shkronjave ك ن «Bëhu»* -D.Arifi
- Haxhere Idrizi- *“Qaj Zot që pi mbeshtetesh nuk t’len duarthatë”* -D.Arifi
- Merjem Haziri- *“Xhahadi bëhet me laps”* -M.Tërnavë
- Rona Jahja- *“Është pjesa e 3-të e natës ajo ku gjërat e vlefshme janë më të kapshme,gjërat e dëshirushme janë më të arritshme”* -D. Arifi
- Rumejsa Krasniqi- *“Allahun Zot, e mu shqetsu, s’bon”*- A.Simnica
- Rumejsa Zhugolli- *«Njerëzit e mëdhenj kanë modesti, e modestinë e shfaqin duke vlerësuar të tjerët.»* - D.Arifi
- Rujejda Berisha- *“Karakterit yt flet më shumë se gjuha jote”* -D. Arifi
- Sara Kabashi- *“Klasa jem është ma e qeta, kur sjon ktu”*. -Sh.Hoxha
- Sara Rrustemi- *“Mos fol gjys anglisht gjys shqip kisha unë well-educated”* -M.Tërnavë
- Selma Gerbeshi- *“Kape veten edhe dil jashtë”* - Sh. Memishi
- Suhejla Nuha- *“The result of ربص is always beautiful”*
- Suhejla Krasniqi- *“Mka rrok sulmi,- po ku mos mem rrok prej juve”*- B.Simnica
- Sumeja Tahiri- *«Njerëzit që nuk duan të përmirsohen, justifikohen»*- D. Arifi
- Shkurta Ajeti- *“Shihemi n’Xhennetin Firdeus, inshaAllah”* -M.Tërnavë
- Vjollca Koliqi- *“Xheneti është i rrethim me vështirsi, e Xhehnemi është i rrethuar me lehtësime”* -H.Jashanica

Fjalët e fundit nga maturantët 12/4

Amela Dushi: *“Win in silence.”*

Anesa Ibrahim: *“Në zhurmën e lumit Ibër dëgjohe zëri i një qyteti që nuk dorëzohet.”*

Anisa Asllani: *“Jetojmë të gjithë të njëjtën natë, por çdokush në errësirën e vet.”*

Anisa Fazliu: *“It’s the little things, always.”*

Diellza Berisha: *“Do apo nuk do njeriu, gjuha nxjerr atë që ka zemra.”*

Dinore Shala: *“Nuk është e vështirë të mësosh, por të largohesh nga ata me të cilët mësove.”*

Edlirë Bekteshi: *“If everything around seems dark, look again, you may be the light.”*

Elvira Bekteshi: *“Enjoy the little things in life, for one day you may look back and realize they were the big things.”*

Emire Hashani: *“Thrilled by the whispers of what future brings.”*

Erda Musliu: *“Shumë gjëra t’i kap syri, por ndiq ato që të kap zemra.”*

Erina Berisha: *“Nëse do ta njohësh një njeri, jepi pushtet.”*

Ernesa Spahiu: *“Beautiful things, even when broken and mended, still don’t lose their perfection.”*

Esmë Metolli: *“Work hard in silence. Let success be your noise.”*

Esmë Osmani: *“Indeed, with hardship comes ease.”*

Esra Bytyqi: *“Climb, fall, survive, repeat...”*

Fetije Krasniqi: *“Mos e prit momentin e duhur, krijohet atë.”*

Loresa Mehmeti: *“Teach your heart to accept disappointments, even from the people you love.”*

Lumnë Sadiku: *“Faleminderit për gjithçka.”*

Medina Musliu: *“If they envy you, know that you’re doing well.”*

Melika Muhaxhiri: *“Suksesi është një fjalë me shkronja të caktuara, por horizontet e saj janë të pakufizuara.”*

Reina Llaloshi: *“Finally.”*

Rumejsa Merxha: *“Edukata është para diturisë, ndërsa dituria është para veprës.”*

Rujejda Bejtullahu: *“High school was just the prologue, now it’s time to write a story worth telling.”*

Rujejda Kaçi: *“Mos u mërzit nga fjalët e atyre që nuk e njohin shpirtin tënd; ndriço edhe më shumë dhe lëri ata të verbohen nga drita jote.”*

Sara Kurtolli: *“Suksesi nuk është një rastësi, por një rezultat i punës së vazhdueshme, disiplinës dhe besimit në veten tënde.”*

Semra Mjaku: *“The first person to judge a human by their physical appearance was Iblis (Shaytan).”*

Shkurtë Krasniqi: *“Besnik bëhu, besë mos zë.”*

Suada Surkishi: *“She did her best and God did the rest.”*

Sumeja Ahmeti: *«Kërkimi i dijes është obligim për çdo musliman».* (Ibn Maxhe, 224)

Sumeja Berisha: *‘And she continued...’*

Sumeja Demolli: *«Të gjithë e tregojnë fytyrën e vërtetë kur mbaron interesi».*

Vlera Zeneli: *“Ai që çdo ditë ka një dëshirë tjetër, asnjëherë nuk arrin të plotësojë dëshirën e vet.”*

Xhezide Osmani: *“Një ditë e humbur nuk kthehet mbrapa. Një jetë e harxhuar nuk kthehet më.”*



KLASA: 10/1 KUJDESTAR: EKREM MAQEDONCI



KLASA: 10/2 KUJDESTAR: HYSNI BEKA



KLASA: 10/3 KUJDESTAR: DRITON ARIFI



KLASA: 10/4 KUJDESTARE: HATIXHE JASHANICA



KLASA: 10/5 KUJDESTAR: SAMIR AHMETI



KLASA: 11/1 KUJDESTAR: ADNAN SIMNICA



KLASA: 11/2 KUJDESTAR: KUJTIM JASHANICA



KLASA: 11/3 KUJDESTARE: VIOLINA ASLLANI



KLASA: 11/4 KUJDESTAR: RRAHIM ALIU



KLASA: 12/1 KUJDESTAR: BESNIK JAHA



KLASA: 12/2 KUJDESTAR: MUHARREM TËRNAVA




KLASA: 12/3 KUJDESTAR: SHKËLZEN HOXHA



KLASA: 12/4 KUJDESTARE: VALBONA ASLLANI



Republika e Kosovës
Bashkësia Islame e Republikës së Kosovës
Sh.M.L. “MEDRESEJA ALBUDDIN” - PRISHTINË



NXËNËSET E DALLUARA



RUVEJDA BEJTULLAHU 12/4
më e dalluara në nivel shkollë

VITI SHKOLLOR 2024/2025



BESIRA SMAJLI 12/3



SUMEJA AHMETI 12/4



DARIA SMAJLI 11/3



EMA BAJGORA 11/4



HILALE AVDYLI 10/3



REJANA ÇUNAKU 10/4



LEJILA DUKAJ 10/5



Republika e Kosovës
Bashkësia Islame e Republikës së Kosovës
Sh.M.L. “MEDRESEJA ALBAUDDIN” - PRISHTINË



NXËNËSIT E DALLUAR



RON BAJOKU 12/1
më i dalluari në nivel shkolle

VITI SHKOLLOR 2024/2025



VISAR RAMA 12/1



ENSAR VESELI 12/2



ANIK BANJSKA 11/1



UVEJS BEQIRI 11/2



JASIR CAKOLLI 10/1



ENGJELL STUBLLA 10/2



REPUBLIKA E KOSOVËS BASHKËSIA ISLAME E REPUBLIKËS SË KOSOVËS ShML “MEDRESEJA ALAUDDIN” - PRISHTINË



Mr. Driton Kufi
profesor



Mr. Elton Mujdreci
profesor



Dr. Avniq Rrahmani
profesor




Mr. Muharem Ermeni
profesor



Mr. Adnan Shkëmbi
profesor




Mr. Samir Abasri
profesor



Mr. Besir, Ali
profesor




Skënder Rrahmani
profesor



Bekir, Saliha
profesor



Mr. Naim Tërapi
Myfti i Kosovës



Mr. Fadil Haxho
deputi



Valid Haxho
deputi



Shaban Metushi
profesor



Mr. Hisham, Kadiu
profesor



Mrs. Samirë Dragosha
profesor



Mr. Zahirë, Abdi
profesor



Mrs. Samirë Kumari
profesor



Mr. Lejla, Gjonali
profesor



Mrs. Ena, Hali
profesor



Mr. Shkëmbi, Adnan
profesor



Mrs. Valbona, Asllani
profesor

12/3

12/4

النبي صلى الله عليه وآله وسلم
“Nëse e ndihmoni fenë e Allahut,
Ai do t’ju ndihmojë juve,
dhe do t’ju bëjë stoikë në rrugën e Tij...”
(Muhamed, 7)

Gjenerata 24
2022/2025
Takimi 2035



AIJA ÇAKODI



ALESJA RRAHMANI



AMIRA OSMANI



ANESA GRASHITICA



ANISA KAMARI



ELMEDINA HALILAJ



ELMA BILALI



ESMIRA SYLEJMANI



ESMIRA BREGOLI



ESMIRA SMAJLI



ESMIRA BREGOLI



ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI



ANISA FAZLI



ANISA KRASNOCI



ANILA BERISHA



BELKISA WYRTA



BESIRA SMAJLI




ELMA KAMARI



ELMEDINA HALILAJ



ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI



EMIRA GASHI



ANILA BERISHA



BELKISA WYRTA



BESIRA SMAJLI



ELMA KAMARI




ELMEDINA HALILAJ




ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI



EMRAH HAZIRI



ANILA BERISHA



BELKISA WYRTA



BESIRA SMAJLI



ELMA KAMARI



ELMEDINA HALILAJ




ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI



FAJONA GASHI



ANILA BERISHA



BELKISA WYRTA



BESIRA SMAJLI



ELMA KAMARI



ELMEDINA HALILAJ




ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI



ESMIRA SMAJLI

fotografite: AS FOTO
dizajni: MEBA design